FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 32

Tiranë – E martë, 2 mars 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 91, datë 17.2.2021	Për transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Mirditë, të një pjese të pronës nr. 988, me emërtim "ish-Reparti Ushtarak nr. 5014", me vendndodhje në Rrëshen, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar.....	4315
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 24.2.2021	Për një shtesë në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar..	4317
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 104, datë 24.2.2021	Për një shtesë në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar.....	4317
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 24.2.2021	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për bashkëpunimin në fushën e arsimit.....	4318
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 5, datë 23.2.2021	Për përcaktimin e numrit të kandidatëve për noterë që do të pranohen në programin e formimit fillestar.....	4321
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 10, datë 26.2.2021	Mbi mënyrën e organizimit dhe realizimit të procedurave të përqendruara të prokurimit publik për autoritetin kontraktor Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.....	4321
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 87, datë 23.2.2021	Për përcaktimin e numrit minimal të noterëve për një degë vendore dhe për miratimin e kufijve territorialë të degëve vendore.....	4322

Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 88, datë 23.2.2021	Për caktimin e numrit të përgjithshëm të zëvendësnoterëve, si dhe caktimin e numrit të noterëve dhe të zëvendësnoterëve për çdo bashki.....	4323
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 89, datë 23.2.2021	Për miratimin e rregullores së trajnimit fillestar dhe vazhdues, përzgjedhjen e trajnerëve, trajnimin dhe vlerësimin e performancës së tyre.....	4325
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 90, datë 23.2.2021	Për miratimin e "Rregullores së provimit të kualifikimit për profesionin e ndërmjetësit".....	4338
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 37, datë 11.2.2021	Mbi miratimin e kërkesës së FTL sh.a., për shtyrjen e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 202, datë 2.12.2020, për miratimin e "Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit".....	4343
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 38, datë 11.2.2021	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin janar 2021.....	4344
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 39, datë 11.2.2021	Mbi heqjen e licencës nr. 348, seria T16, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë "Nordic Invest Group" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 121, datë 21.7.2016.....	4345
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 40, datë 11.2.2021	Mbi heqjen e licencës nr. 405, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë "Malsia solar 1" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 105, datë 30.4.2018.....	4347
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 41, datë 11.2.2021	Mbi heqjen e licencës nr. 406, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Malsia solar 2" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 30.4.2018.....	4348
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 42, datë 11.2.2021	Mbi heqjen e licencës nr. 407, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Malsia solar 3" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 107, datë 30.4.2018.....	4350
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 43, datë 11.2.2021	Mbi heqjen e licencës nr. 398, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Wind Power Albania" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 12.3.2018.....	4351
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 44, datë 11.2.2021	Mbi heqjen e licencës nr. 413, seria F18, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Wind Power Albania" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 4.6.2018.....	4353
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 45, datë 11.2.2021	Mbi heqjen e licencës nr. 359, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë "Enpi" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 36, datë 6.3.2017.....	4354
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 46, datë 11.2.2021	Mbi heqjen e licencës nr. 384, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Energy to Energy" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.9.2017.....	4356

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 47, datë 11.2.2021	Mbi plotësimin e kushtit të vendimit nr. 114, datë 22.7.2019, "Mbi licencimin e shoqërisë 'SPE Gjadër' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Gjadër nr. 1/1', me kapacitet të instaluar 2134 kw, HEC 'Gjadër nr. 1/2', me kapacitet të instaluar 4406 kw, HEC 'Gjadër nr. 2', me kapacitet të instaluar 2983 kw, HEC 'Gjadër nr. 3', me kapacitet të instaluar 3874 kw, HEC 'Gjadër nr. 4', me kapacitet të instaluar 5922 kw, HEC 'Gjadër nr. 5', me kapacitet të instaluar 5619 kw, me kapacitet total të instaluar 24938 kw", të ndryshuar.....	4357
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6/18, datë 1.3.2021	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Spitalit Rajonal Fier".....	4359

VENDIM
Nr. 91, datë 17.2.2021

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA MIRDITË, TË NJË PJESE TË PRONËS NR. 988, ME EMËRTIM "ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5014", ME VENDNDODHJE NË RRËSHEN, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Mirditë, të një pjese të pronës nr. 988, me emërtim "Ish-reparti ushtarak nr. 5014", me vendndodhje në Rrëshen, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ndërtimin e banesave individuale dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit në Njësinë Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, për të prekurit nga tërmeti i datës 26.11.2019.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, të hiqet nga prona nr. 988, me emërtim "Ish-reparti ushtarak nr. 5014", me vendndodhje në Rrëshen, sipërfaqja sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Mirditë.

3. Bashkisë Mirditë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, Bashkia Mirditë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama


PLAN RILEVIMI
Prona Nr.988 "Ish Rep.Usht. Nr.5014", Rrëshen
PRONARI: SHTET/ Në përgjegjësi administrimi Ministria e Mbrojtjesr DATË 16/02/2021 QËLLIMI: Transferim
VENDNDODHJA
Bashkia: Mirditë DVASHK/ZVASHK Mirditë Nr.Pasurisë 1/12 ZK 3224 Indeksi i Hartës Rr B-2
TE DHËNAT E PASURISË
Lloi i pasurisë: Truall Sip e pasurisë 36 160m² Sip e gjurmës së ndërtimit = 3 124m² Nr. kateve Nr. pemeve
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)
Kabinë elek.
Vk
rrenoje
tunel (8.7 x 4.2)
tunel (2 x 2)
tunel (8.7 x 4.2)
cisterna (3)
SH 1: 2500
Realizoi IGJIU Topograf Ramiz Haxhiu
TEKNOLOGJIA E MATJEVE
PËRCAKTIMI I KUFIRIT
SHËNIME TË VEÇANTA:
Ky planrilevimi o hartua në zbatim të shkresës së Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura nr.868/1, datë 11.02.2021, bazuar në dokumentacionin hartografik b/lidhur kësaj shkrese.
DREJTORI I IGJIU
Ark. Enea SINOIMERI
REALIZOI PËR ASHK
Specialisti
DVASHK
Nënshkrimi
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori
Nënshkrimi/ Vula
PRONARI/BASHKIPRONARËT-DEKLARIM NË LIDHJE ME KUFITARËT
EMRI
NËNSHKRIMI

VENDIM
Nr. 103, datë 24.2.2021

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve"; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën "b", të pikës 1/3, të vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet emërtesa "Drejtoria e Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e institucionit dhe të fillojnë nga momenti i emërimit të nëpunësve në detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 104, datë 24.2.2021

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 717, DATË 23.6.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE BUXHETORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. I/1, bashkëlidhur vendimit nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në numrin rendor 6, pas emërtesës "Fotograf në ATSH" shtohet emërtesa "Vëzhgues terreni në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve".

2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2021, të përballohen nga buxheti i miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 107, datë 24.2.2021

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E ARSIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për bashkëpunimin në fushën e arsimit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E ARSIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Turqisë, më tej referuar si "Palët",

duke besuar në përfitimin e rritjes së bashkëpunimit në fushën e arsimit midis dy vendeve që kjo marrëveshje do t'u sjellë të dyja palëve,

duke shprehur gatishmërinë për të forcuar më tej marrëdhëniet ndërmjet institucioneve të tyre përgjegjëse për arsimin,

në respektim të legjislacioneve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare në fuqi të dy vendeve në fushën e arsimit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të rrisë bashkëpunimin, midis institucioneve përkatëse të të dy palëve, në fushën e arsimit, mbi bazën e barazisë dhe respektit reciprok, në përputhje me legjislacionet kombëtare të palëve dhe legjislacionin ndërkombëtar.

Neni 2
Fusha e bashkëpunimit

Palët do të promovojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në fushat e mëposhtme:

1. Nxitjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit dhe botimeve shkencore në fushat e arsimit.
2. Shkëmbimin e akademikëve, ekspertëve të arsimit, mësuesve, administratorëve të institucioneve arsimore dhe nxënësve të arsimit të mesëm dhe studentëve të arsimit të lartë.
3. Shkëmbimin e përvojave në fushën e arsimit të lartë, arsimit të mesëm, arsimit special, arsimit profesional dhe teknik, si dhe trajnimit të mësuesve dhe kualifikimit të mësuesve, organizimin e programeve të trajnimit, duke zbatuar projekte të përbashkëta.
4. Shkëmbimin e përvojave në fushën e teknologjive të reja të aplikuara në arsim.
5. Shkëmbimin e përvojave në fushën e zhvillimit të kurrikulës.
6. Shkëmbimin e programeve të zhvillimit profesional për administratorët, mësuesit dhe personelin në fushën e arsimit.
7. Kryerjen e hulumtimeve dhe kërkimeve të përbashkëta në fushën e arsimit.
8. Shkëmbimin e informacionit, në mënyrë reciproke, lidhur me sistemet e matjes dhe vlerësimit të zbatuara në të dy vendet.
9. Shkëmbimin e përvojave në hartimin dhe përmirësimin e materialeve arsimore të përdorura në të dy vendet.
10. Inkurajimin reciprok të pjesëmarrjes së studentëve në konkurset shkencore dhe kulturore të organizuara në të dy vendet.
11. Promovimin e bashkëpunimit për zhvillimin e programeve të përbashkëta, marrëdhënieve binjakëzuese të shkollave dhe aktiviteteve të studentëve, midis institucioneve përkatëse arsimore të palëve.

12. Inkurajimin për pjesëmarrje të ndërsjellë në aktivitete, të tilla si: seminare, ekspozita, konferenca dhe studime shkencore etj., në fushën e arsimit.

Neni 3
Mësimdhënia dhe nxënia e gjuhëve zyrtare

1. Palët do të inkurajojnë mësimdhënien dhe nxënien e gjuhës zyrtare të palës tjetër, si dhe letërsinë dhe kulturën e palës tjetër, brenda sistemit të tyre arsimor.

2. Pala shqiptare synon të kryejë një vlerësim për kërkesat, për të mësuar gjuhën turke si një gjuhë e huaj si lëndë me zgjedhje të lirë, me qëllim shpalljen e një programi pilot në gjuhën turke.

3. Pala shqiptare do të sigurojë çdo vit kuota për pjesëmarrjen e studiuesve/studentëve turq në seminaret/kurset verore të gjuhës dhe kulturës shqiptare.

4. Pala turke do të sigurojë çdo vit kuota për pjesëmarrjen e studiuesve/studentëve shqiptarë në seminaret/kurset verore në gjuhën dhe kulturën turke.

Neni 4
Personeli arsimor

1. Palët do të lehtësojnë shkëmbimin e mësuesve dhe akademikëve në vendet e njëri-tjetrit për të mësuar gjuhët zyrtare, brenda kuadrit të legjislacioneve të tyre kombëtare, dhe do të informojnë palën pritëse përmes rrugëve diplomatike.

2. Palët do të lehtësojnë procedurat e dhënies së vizave, lejeve të qëndrimit dhe të punës për mësuesit dhe akademikët e caktuar, si dhe anëtarët e familjeve të tyre brenda objektit të kësaj marrëveshjeje.

Neni 5
Bursat

1. Palët, çdo vit, do të japin reciprokisht bursa për kurse gjuhe, arsim të lartë dhe kërkime, duke marrë në konsideratë fushat e nevojshme dhe brenda kufijve të mundësive të tyre financiare. Numri i bursave dhe kushteve, lidhur me bursat, do t'i nënshtrohen legjislacionit përkatës të palëve.

2. Procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe përcaktimit të kandidatëve për arsim të lartë dhe studiuesve, të cilët janë shtetas të Republikës së Shqipërisë dhe do të bëhen bursistë në Turqi, do të kryhen brenda kuadrit të legjislacionit turk për bursat duke informuar Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet rrugëve diplomatike.

3. Pala shqiptare do të japë bursa për studentët turq brenda kufijve të mundësive financiare. Procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe përcaktimit të kandidatëve për arsim të lartë dhe studiuesve të cilët janë shtetas të Republikës së Turqisë dhe do të bëhen bursistë në Shqipëri, do të kryhen brenda kuadrit të legjislacionit shqiptar për bursat duke informuar Ministrinë e Arsimit Kombëtar të Republikës së Turqisë, nëpërmjet rrugëve diplomatike.

4. Palët, në përputhje me legjislacionet e tyre të brendshme, do të sigurojnë mundësi për studentët që dëshirojnë të studiojnë në vendin e palës tjetër, me shpenzimet e tyre.

5. Palët do të marrin masat e nevojshme për të lehtësuar zgjidhjen e problemeve të studentëve që studiojnë me të ardhurat e tyre dhe studentëve bursistë, si dhe studiuesve në vendet e tyre.

Neni 6
Grupi i Punës i Përbashkët Arsimor

1. Palët do të krijojnë një Grup Pune të Përbashkët për Arsimin në mënyrë që të lehtësojnë zbatimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e kësaj marrëveshjeje përmes dërgimit periodik të raporteve drejtuar institucioneve përkatëse.

2. Grupi i Punës i Përbashkët i Arsimit do të bashkëkryesohet nga ministrat e arsimit të palëve ose zyrtarë të lartë të autorizuar. Përfaqësuesit e institucioneve përkatëse do të takohen një herë në dy vjet ose nëse është e nevojshme, me kërkesë të njërës prej palëve, ose në Turqi ose në Shqipëri.

3. Nëse palët nuk mund të mblidhen në një takim, do të shkëmbehen dokumente në vend të takimit.

Neni 7
Ekuivalentimi i diplomës

Palët do të shkëmbejnë informacionin dhe dokumentacionin përkatës, lidhur me sistemet e tyre përkatëse të arsimit, nëpërmjet autoriteteve të tyre kompetente për njohjen reciproke dhe ekuivalentimin e vlerësimeve, transkripteve, dëftesave arsimore, tërheqjen e dëftesave, titujve dhe diplomave të lëshuara në arsimin fillor dhe të mesëm, si dhe arsimin e lartë, si edhe do të

bashkëpunojnë në këtë drejtim, kur është e nevojshme.

Neni 8
Institucionet arsimore dhe kulturore

Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, palët, nëpërmjet grupit të punës së nivelit të lartë, do të hartojnë rregullore administrative, përfshirë protokollet e shtetit pritës, me agjencitë, institucionet dhe shoqatat e palës tjetër, përgjegjës për edukimin, kulturën dhe trajnimin.

Neni 9
Mbrojtja e të drejtës së autorit dhe të drejtave të pronësisë intelektuale

Palët do të mbrojnë të drejtat e tyre të pronësisë intelektuale, të krijuara dhe të përdorura brenda kuadrit të bashkëpunimit të kësaj marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionet e tyre kombëtare dhe traktatet ndërkombëtare të cilat ato kanë nënshkruar. Sipas kësaj marrëveshjeje, pronësia intelektuale kuptohet sipas shpjegimit të dhënë në nenin 2, të Konventës për Themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, në Stokholm, më 14 korrik 1967.

Neni 10
Institucionet zbatuese

Kjo marrëveshje do të zbatohet nga institucionet e mëposhtme:

- në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës e Shqipërisë;
- në emër të qeverisë së Republikës së Turqisë: Ministria e Arsimit Kombëtar të Republikës së Turqisë.

Neni 11
Dispozitat financiare dhe teknike

1. Zbatimi i veprimtarive të rëna dakord në këtë marrëveshje do të varet nga gjendja e mjeteve financiare dhe stafit të palëve.
2. Palët do të mbulojnë vetë shpenzimet e secilit delegacion.

Neni 12
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet në mënyrë miqësore përmes negociatave ose konsultimeve midis palëve.

Neni 13
Shtesa dhe ndryshime

Me përjashtim të aspekteve financiare, çdo shtesë apo ndryshim mund të bëhet në këtë marrëveshje, me pëlqim të ndërsjellët të palëve. Shtesat dhe ndryshimet do të bëhen në formën e një protokolli të veçantë i cili do të jetë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje dhe do të hyjë në fuqi në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenin 14 të marrëveshjes.

Neni 14
Dispozita përfundimtare

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin palët njoftojnë njëra-tjetrën, përmes rrugëve diplomatike, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të saj.
2. Kjo marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë 5-vjeçare (pesëvjeçare). Kjo marrëveshje do të zgjatet pas miratimit nga palët, përmes rrugëve diplomatike, për një periudhë 3-vjeçare (trevjeçare).
3. Vazhdimi i aktiviteteve dhe projekteve në vazhdim ose të nisura, pas përfundimit të kësaj marrëveshjeje, do të konsiderohen rast pas rasti para përfundimit të kësaj marrëveshjeje.

Bërë në Ankara, më 6 janar 2021, në dy kopje në gjuhën shqipe, turke, dhe angleze, të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të mosmarrëveshjeve në interpretimin e kësaj marrëveshjeje, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	NË EMËR TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË
Evis Kushi	**Ziya Selçuk**
Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Ministër i Arsimit Kombëtar

UDHËZIM
Nr. 5, datë 23.2.2021

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË KANDIDATËVE PËR NOTERË QË DO TË PRANOHEN NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 6 dhe të pikës 3, të nenit 142, të ligjit nr. 110/2018, "Për Noterinë",

UDHËZOJ:

1. Numri i kandidatëve për noterë, që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Qendrës Shqiptare të Trajnimit të Noterëve, është - 10 (dhjetë).

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe Qendra Shqiptare e Trajnimit të Noterëve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

UDHËZIM
Nr. 10, datë 26.2.2021

MBI MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCEDURAVE TË PËRQENDRUARA TË PROKURIMIT PUBLIK PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR AUTORITETI KOMBËTAR I VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMËVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si rezultat i mungesës së kapaciteteve në institucionet e varësisë për realizimin me sukses të procedurave

UDHËZOJ:

1. Realizimin e procedurave, me vlerë mbi 800,000 (tetë qind mijë) lekë pa TVSH në mënyrë të përqendruar për Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural merr përsipër rolin e Organit Qendror Blerës për zhvillimin e procedurave së prokurimit në emër dhe për llogari të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për kryerjen e të gjithë procedurave të prokurimit sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, që nga hartimi i specifikimeve teknike, njoftimi i kontratës e deri te publikimi i njoftimit të nënshkrimit të kontratës në sistemin elektronik të prokurimeve.

4. Pas njoftimit të fituesit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dërgon pranë Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, dokumentacionin e plotë në formë të shkruar për të vijuar me nënshkrimin e kontratës përkatëse.

5. Për procedurat e prokurimit të cilat realizohen nga ABP dhe/ose AKSHI, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, merr përsipër hartimin e specifikimeve teknike, si dhe dërgimin e tyre pranë autoriteteve përkatëse.

6. Autoriteti Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve është përgjegjës për ndjekjen dhe realizimin e kontratës.

7. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve do të jetë përfituesi i mallrave/shërbimeve/punëve objekt prokurimi.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi

URDHËR
Nr. 87, datë 23.2.2021

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT MINIMAL TË NOTERËVE PËR NJË DEGË VENDORE DHE PËR MIRATIMIN E KUFIJVE TERRITORIALË TË DEGËVE VENDORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar; të nenit 79, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 110/2018, "Për Noterinë",

URDHËROJ:

1. Dhoma Kombëtare e Noterisë organizohet në 6 (gjashtë) degë vendore, për çdo zonë ku shtrin kompetencën e saj tokësore një gjykatë apeli.

2. Kufijtë territorialë të degëve vendore dhe numri i noterëve për çdo degë është sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohet struktura përgjegjëse për noterinë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

Aneks nr. 1

Dega vendore	Kufijtë territorialë	Numri i noterëve të degës vendore
Dega Vendore e Noterisë Tiranë	Shtrihet në kufijtë territorialë të bashkive Tiranë, Vorë dhe Kamzë	**49 noterë**
Dega Vendore e Noterisë Durrës	Shtrihet në kufijtë territorialë të bashkive Durrës, Shijak, Rrogozhinë, Kavajë, Elbasan, Belsh, Përrenjas, Cërrik, Krujë, Peqin, Gramsh dhe Librazhd	**40 noterë**
Dega Vendore e Noterisë Shkodër	Shtrihet në kufijtë territorialë të bashkive Shkodër, Dibër, Tropojë, Pukë, Kukës, Bulqizë, Kurbin, Lezhë, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Mat, Klos, Mirditë, Fushë-Arrëz dhe Has	**36 noterë**
Dega Vendore e Noterisë Korçë	Shtrihet në kufijtë territorialë të Bashkive Korçë, Pogradec, Kolonjë, Maliq, Devoll dhe Pustec	**14 noterë**
Dega Vendore e Noterisë Vlorë	Shtrihet në kufijtë territorialë të bashkive Vlorë, Fier, Mallakastër, Lushnjë, Patos, Skrapar, Berat, Kuçovë, Poliçan, Ura Vajgurore, Divjakë, Roskovec dhe Selenicë	**38 noterë**
Dega Vendore e Noterisë Gjirokastër	Shtrihet në kufijtë territorialë të bashkive Gjirokastër, Sarandë, Delvinë, Tepelenë, Përmet, Memaliaj, Himarë, Dropull, Finiq, Libohovë, Konispol dhe Këlcyrë	**12 noterë**

URDHËR
Nr. 88, datë 23.2.2021

PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË ZËVENDËSNOTERËVE, SI DHE CAKTIMIN E NUMRIT TË NOTERËVE DHE TË ZËVENDËSNOTERËVE PËR ÇDO BASHKI

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar; të nenit 10, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë",

URDHËROJ:

1. Numri i noterëve që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë është 189 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë).

2. Numri i përgjithshëm i zëvendësnoterëve është 40 (dyzet).

3. Numri i noterëve për çdo bashki, deri në vitin 2026, si dhe numri i pozicioneve të zëvendësnoterëve për çdo bashki është sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet struktura përgjegjëse për noterinë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

5. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

Aneks nr. 1

Bashkia	Numri i noterëve	Numri i zëvendësnoterëve
Tiranë	40	20
Durrës	13	4
Elbasan	10	3
Shkodër	9	3
Fier	11	4
Vlorë	8	3
Kamzë	7	1
Lushnjë	5	1
Korçë	6	1
Lezhë	5	
Dibër	3	
Pogradec	4	
Berat	4	
Krujë	3	
Kukës	2	
Kurbin	3	
Maliq	1	
Kavajë	3	
Divjakë	2	
Librazhd	2	
Kuçovë	2	
Bulqizë	2	
Malësi e Madhe	2	
Vau i Dejës	2	

Gjirokastër	4	
Shijak	2	
Mat	3	
Cërrik	1	
Ura Vajgurore	1	
Mallakastër	1	
Devoll	2	
Peqin	2	
Vorë	2	
Përrenjas	1	
Gramsh	1	
Sarandë	3	
Patos	1	
Rrogozhinë	1	
Mirditë	1	
Roskovec	1	
Tropojë	1	
Belsh	1	
Has	0	
Klos	1	
Selenicë	0	
Skrapar	1	
Kolonjë	1	
Pukë	1	
Poliçan	1	
Memaliaj	1	
Përmet	1	
Tepelenë	1	
Konispol	0	
Delvinë	1	
Himarë	1	
Fushë-Arrëz	1	
Finiq	0	
Këlcyrë	0	
Libohovë	0	
Dropull	0	
Pustec	0	

URDHËR
Nr. 89, datë 23.2.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË TRAJNIMIT FILLESTAR DHE VAZHDUES, PËRZGJEDHJEN E TRAJNERËVE, TRAJNIMIN DHE VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË TYRE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7, paragrafi 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, si dhe të pikës 5, të nenit 5/1, të ligjit nr. 10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores së trajnimit fillestar dhe vazhdues, përzgjedhjen e trajnerëve, trajnimin dhe vlerësimin e performancës së tyre, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.
4. Rregullorja dhe Programi i Trajnimeve, miratuar me vendimin nr. 12, datë 16.12.2016, shfuqizohet.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

RREGULLORE
PËR TRAJNIMIN FILLESTAR DHE VAZHDUES, PËRZGJEDHJEN E TRAJNERËVE, TRAJNIMIN DHE VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË TYRE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton:
a) objektivat e trajnimit fillestar për kandidatët për ndërmjetës, programin dhe modulet e trajnimit, organizimin dhe metodat e mësimdhënies, mënyrën e kontrollit të njohurive dhe të aftësive, rregullat dhe kushtet për lëshimin e vërtetimit për përfundimin me sukses të programit të trajnimit fillestar, si dhe rregulla të tjera për trajnimin fillestar;
b) objektivat e programit të trajnimit vazhdues, listën e disiplinave mësimore dhe të veprimtarive të tjera formuese, organizimin e mësimdhënies, rregullat e frekuentimit, mënyrën e kontrollit të njohurive dhe aftësive, aspektet financiare, si dhe çështje të tjera të hollësishme për programin e trajnimit vazhdues të ndërmjetësve; si dhe
c) rregullat në lidhje me përzgjedhjen e trajnerëve, trajnimin dhe vlerësimin e performancës së tyre.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Rregullorja zbatohet për trajnimin fillestar dhe vazhdues për ndërmjetësit, përzgjedhjen e trajnerëve, trajnimin dhe vlerësimin e performancës së tyre.

Neni 3
Përkufizime

a) "Program i trajnimit fillestar" përfshin një tërësi veprimtarish akademike dhe/ose kërkimore-shkencore me ngarkesë akademike normale 60 (gjashtëdhjetë) kredite ECTS në një vit akademik, përfundimi me sukses i të cilave i

jep të drejtën kandidatit për ndërmjetës të pajiset me vërtetimin përkatës;

b) "Trajnim vazhdues", nënkupton trajnimet vazhduese të detyrueshme për ndërmjetës, të organizuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, brenda të cilave ndërmjetësi plotëson numrin e caktuar të ditëve të trajnimit, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm profesional në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje;

c) "Vërtetim" është dëshmia e lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve ("Dhoma") për përfundimin me sukses të programit të trajnimit fillestar për kandidatët për ndërmjetës;

ç) "Certifikatë" është vërtetimi i lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve për përfundimin me sukses të trajnimeve vazhduese të detyrueshme;

d) "Kredit evropian (ECTS)" është përcaktimi i kreditit sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve, që duhet të përfitohen nga kandidati për ndërmjetës gjatë programit të detyrueshëm të trajnimit fillestar 1-vjeçar dhe do të thotë një minimum orësh mësimore në auditor dhe orësh punë e pavarur që kandidati për ndërmjetës duhet të realizojë gjatë programit të detyrueshëm të trajnimit fillestar 1-vjeçar; 1 (një) ECTS është minimumi 10 (dhjetë) orë mësimore në auditor dhe 15 (pesëmbëdhjetë) orë punë e pavarur;

dh) "Kredit" është koha e zhvillimit të trajnimit vazhdues profesional, që llogaritet në 60 (gjashtëdhjetë) minuta për 1 (një) kredit. Në rastet kur ndërmjetësi ka marrë pjesë si trajner në programet e trajnimit fillestar ose vazhdues, kreditet që regjistrohen në dosjen e tij personale përllogariten në bazë të kriterit 60 (gjashtëdhjetë) minuta vlerësohen me 2 (dy) kredite;

e) "Ditë trajnimi" është dita e trajnimit vazhdues profesional, që realizohet në jo më pak se 5 (pesë) orë dhe që vlerësohet me 5 (pesë) kredite. Ndërmjetësi merr pjesë në programet e trajnimit vazhdues dhe në veprimtaritë e tjera trajnuese, për të paktën 5 (pesë) ditë në vit, të zhvilluara nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve.

Neni 4

Qëllimi dhe objektivat e trajnimit fillestar dhe vazhdues

Qëllimi dhe objektivat e trajnimit fillestar dhe vazhdues, konsistojnë si më poshtë:

a) ofrimin e një programi trajnimi të përshtatshëm të kandidatëve për ndërmjetës dhe ndërmjetësve anëtarë të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, në fushën civile, tregtare, të punës, familjare, pronësisë intelektuale, të drejtave të konsumatorëve, të mosmarrëveshjeve midis organeve të administratës publike dhe subjekteve private, të drejtave me karakter pasuror si të drejtat e pronësisë ose të bashkëpronësisë, pjesëtimin e pasurisë, paditë për kërkimin e sendit, për paditë mohuese e për paditë për pushimin e cenimit të posedimit, mosmarrëveshjet që rrjedhin nga mospërmbushjet e detyrimeve kontraktuese, ato që kanë si objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktues dhe fushës së së drejtës penale sipas parashikimeve të pikës 3, të neni 2, të ligjit nr. 10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", të ndryshuar, si dhe nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur;

b) krijimin e një programi trajnues, që reflekton dhe mundëson përvetësimin e kompetencave dhe zbatimin e detyrave në ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit;

c) zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe aftësive praktike, ngritjen profesionale të ndërmjetësve në përmbushjen e veprimtarisë sipas legjislacionit në fuqi;

ç) ofrimin e mundësisë për përfituesit, që duke u angazhuar në punë ekipore të rrisin zhvillimin e tyre profesional në kontribut të zhvillimit të përgjithshëm të veprimtarisë së ndërmjetësimit;

d) realizimin e botimit të materialeve trajnuese në fushën e ndërmjetësimit;

dh) nxitjen e frymës së bashkëpunimit profesional ndërmjet kandidatëve për ndërmjetës në programin e trajnimit fillestar, si dhe ndërmjet pjesëmarrësve në programin e trajnimit vazhdues, përmes trajnimeve përkatëse.

Neni 5
Synimi për kualifikim

Zhvillimi dhe kualifikimi profesional i kandidatëve për ndërmjetës në trajnimin fillestar, si dhe i pjesëmarrësve në trajnimin vazhdues, arrihet duke përvetësuar kompetencat si vijon:

a) përmbushja e kërkesave të përgjithshme për profesionin e ndërmjetësit në Shqipëri;

b) njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme për performancë të suksesshme profesionale si ndërmjetës;

c) aftësia për t'u përballur me kërkesa dhe sfida që ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme;

ç) aftësia për të ushtruar kompetencat e kërkuara drejtpërsëdrejti në punë (profesionale, metodike, sociale dhe personale), reflektim të pavarur për çështje të fushës së ndërmjetësimit, alternative, argumentim bindës;

d) zhvillimi i aftësive praktike dhe forcimi i ndërgjegjësimit mbi ndërlidhjen e përmasave juridike, sociale dhe ekonomike;

dh) aftësi për kërkime të pavarura në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional;

e) kërkesat për menaxhimin dhe përmbushjen me sukses të procesit të punës (vetorganizimi dhe disiplina, aftësia për t'u përballur me ngarkesë të lartë pune).

Neni 6
Veprimtaria administrative dhe akademike e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve

Veprimtaria administrative dhe akademike e Dhomës, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga kjo rregullore, përfshin:

a) administrimin e procesit të kërkesave për regjistrim të të interesuarve për kryerjen e programit të trajnimit fillestar ose trajnimin vazhdues;

b) hartimin, përditësimin dhe publikimin e kalendarit të veprimtarive, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, në faqen zyrtare të Dhomës;

c) organizimin e trajnimit të detyrueshëm fillestar, sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 10385/2011 dhe kësaj rregulloreje;

ç) organizimin e trajnimeve vazhduese, sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 10385/2011 dhe kësaj rregulloreje;

d) krijimin dhe administrimin e regjistrit të të dhënave për programin e trajnimit fillestar dhe regjistrit për programin e trajnimit vazhdues;

dh) kryerjen e studimeve kërkimore-shkencore në funksion të përmirësimit të veprimtarive të trajnimit fillestar dhe vazhdues;

e) bashkëpunimin ndërinstitucional për hartimin dhe zbatimin e kurrikulave, kritereve dhe standardeve në lidhje me programin e trajnimit fillestar 1-vjeçar dhe programin e trajnimit vazhdues me aktorë, partnerë, bashkëpunëtorë të rëndësishëm në fushën e edukimit dhe formimit profesional;

ë) bashkëpunimin me institucione brenda dhe jashtë vendit për mbështetje akademike dhe shkencore;

f) bashkëpunimin me institucione brenda dhe jashtë vendit për certifikime kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e formimit profesional.

KREU II
TRAJNIMI FILLESTAR

SEKSIONI I
TRAJNIMI FILLESTAR DHE ORGANIZIMI

Neni 7
Programi i detyrueshëm i trajnimit fillestar

1. Trajnimi fillestar, fokusohet në zhvillimin e kompetencave profesionale të kandidatëve për ndërmjetës, aftësive praktike, si dhe vlerat etike të tyre, si më poshtë:

a) ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve profesionale për legjislacionin vendës dhe ndërkombëtar;

b) hartimin e akteve përkatëse në funksion të ushtrimit të kompetencave, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) aplikimin e rregullave etike;

ç) përshtatjen me rrethana dhe situata specifike gjatë ushtrimit të kompetencave;

d) zhvillimin e aftësive në fushën e ndërmjetësimit;

dh) zhvillimin e aftësive sociale;

e) zhvillimin e praktikave me institucionet e ndërlidhura me punën dhe veprimtarinë e ndërmjetësimit;

ë) zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese, organizative dhe menaxhuese.

2. Kompetencat e mësipërme do të zhvillohen nëpërmjet moduleve të trajnimit, të cilat janë bashkëngjitur si aneks i kësaj rregulloreje, trajnimit praktik, si dhe punës praktike që mund t'i caktohet nga trajnerët.

3. Programi i trajnimit fillestar përbëhet së paku nga temat, mbi:

a) legjislacionin në fushën civile, tregtare, të punës dhe familjare, pronësisë intelektuale, të drejtave të konsumatorëve, të mosmarrëveshjeve midis organeve të administratës publike dhe subjekteve private;

b) të drejtat me karakter pasuror si të drejtat e pronësisë ose të bashkëpronësisë, pjesëtimin e pasurisë, paditë për kërkimin e sendit, për paditë mohuese e për paditë për pushimin e cenimit të posedimit, mosmarrëveshjet që rrjedhin nga mospërmbushjet e detyrimeve kontraktuese, ato që kanë si objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktues;

c) fushën e së drejtës penale sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 2, të ligjit nr. 10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", të ndryshuar, si dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur;

ç) etikën profesionale;

d) standardet dhe legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar mbi ndërmjetësimin;

dh) mënyrën e referimit të rasteve për ndërmjetësim dhe efektet e një marrëveshjeje ndërmjetësimi;

e) sistemin e zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve dhe dallimeve ndërmjet metodave të ndryshme të negocimit;

ë) menaxhimin e konfliktit dhe mosmarrëveshjeve, shkaqeve dhe motiveve të situatave konfliktuale;

f) dallimet ndërmjet pozicioneve, nevojave dhe interesave;

g) inteligjencën emocionale dhe menaxhimin e emocioneve dhe të palëve.

4. Për raste të veçanta, nisur nga nevojat e kandidatëve për ndërmjetës, të ndryshimeve të legjislacionit dhe problemeve të praktikës, karakteri i programit të trajnimit fillestar mund të lejojë përfshirjen e tematikave të tjera.

Neni 8
Organizimi i trajnimit fillestar

1. Programi i trajnimit fillestar është një program 1-vjeçar, që ofrohet për kandidatët për ndërmjetës sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10385/2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" dhe kësaj rregulloreje.

2. Trajnimi fillestar ofrohet nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve. Dhoma i propozon ministrit të Drejtësisë për miratim programin e trajnimit fillestar të ofruar prej saj. Trajnimi fillestar mund të ofrohet edhe nga institucione të arsimit të lartë, të akredituara sipas ligjit, programi i të cilave miratohet paraprakisht nga ministri i Drejtësisë, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve.

3. Programi i trajnimit fillestar të detyrueshëm 1-vjeçar organizohet në bazë të numrit të krediteve evropiane (ECTS) dhe përmban jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) kredite evropiane (ECTS).

4. Programi i trajnimit fillestar të detyrueshëm 1-vjeçar organizohet sipas vitit kalendarik. Për realizimin e këtij programi, Dhoma dhe institucionet e arsimit të lartë hartojnë dhe miratojnë kalendarin e veprimtarive trajnuese të trajnimit fillestar, numrin e sesioneve trajnuese, kohëzgjatjen dhe kreditet e përfituara.

5. Dhoma merr masat e nevojshme administrative dhe akademike dhe kujdeset në mënyrë të posaçme për trajnimin fillestar të kandidatëve për ndërmjetës.

6. Programi tematik dhe kalendari i të gjitha veprimtarive që do të zhvillohen në kuadër të trajnimit fillestar, së bashku me metodologjinë e trajnimit dhe modelin e formularit të regjistrimit, publikohet në formë elektronike në faqen zyrtare të Dhomës.

Neni 9
Regjistrimi në trajnimin fillestar

1. Dhoma, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara fillimit të programit të trajnimit fillestar, publikon në faqen zyrtare ftesën për pjesëmarrje në programin e trajnimit fillestar bashkë me programin tematik dhe kalendarin e veprimtarive trajnuese, të cilat do të ndiqen prej personave të interesuar.

2. Personat e interesuar për ndërmjetës, të cilët përmbushin kushtet e parashikuara në shkronjat "a" dhe "c", të nenit 5, të ligjit nr. 10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", të ndryshuar, paraqesin, brenda afatit të përcaktuar në ftesë, kërkesën për regjistrim sipas modelit të formularit të regjistrimit, që publikohet në faqen zyrtare të Dhomës.

3. Kërkesa për regjistrim shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm, që vërteton përmbushjen e kushteve të mësipërme dhe paraqitet brenda afatit të përcaktuar në ftesën e publikuar nga Dhoma.

4. Këshilli Drejtues i Dhomës, përpara fillimit të programit të trajnimit fillestar, krijon një Komision të posaçëm, i cili verifikon kërkesat për regjistrim të personave të interesuar për ndërmjetës.

5. Pas kryerjes së verifikimit mbi përmbushjen e kushteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, Komisioni harton një relacion shpjegues për secilin person të interesuar, në të cilin përcaktohen vendimi dhe arsyet e pranimit ose refuzimit të kërkesës për regjistrim. Lista e kandidatëve të kualifikuar dhe lista e kandidatëve të skualifikuar, publikohet në faqen zyrtare të Dhomës.

6. Personat e interesuar për ndërmjetës, që janë renditur në listën e kandidatëve të skualifikuar, kanë të drejtë të paraqesin një ankim pranë Këshillit Drejtues të Dhomës, duke i bashkëlidhur dokumentacionin që provon përmbushjen e kritereve ligjore, brenda 3 (tri) ditëve nga data e shpalljes së listës.

7. Këshilli Drejtues shqyrton ankimin brenda 5 (pesë) ditëve nga data e paraqitjes dhe njofton personin e interesuar në lidhje me vendimin për ankimin e paraqitur. Ndaj vendimit të Këshillit Drejtues mund të paraqitet ankim në gjykatën administrative kompetente brenda 30 (tridhjetë) ditëve, sipas ligjit për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

SEKSIONI II
ORGANIZIMI I MËSIMDHËNIES

Neni 10
Organizimi i procesit të mësimdhënies

1. Programi i mësimdhënies për kandidatët për ndërmjetës, në rastet kur diktohet nga numri i madh i kandidatëve, mund të organizohet i ndarë në grupe. Çdo grup ka një numër të caktuar pjesëmarrësish në raport me numrin e kandidatëve të regjistruar.

2. Kur programi i mësimdhënies është i organizuar në grupe, për çdo grup garantohet zbatim i njëjtë i programit mësimor.

3. Orari mësimor për çdo grup realizohet në formën e orëve mësimore javore, që hartohen nga trajnerët, mbështetur në planin mësimor. Në orarin javor harmonizohen elementet mësimore (leksione, debate profesionale, kërkim i pavarur etj.), duke siguruar shpërndarjen e ngarkesës, si dhe përcaktohet koha dhe auditori kur dhe ku do të zhvillohet mësimi.

4. Orari mësimor është i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë kandidatët për ndërmjetës dhe trajnerët. Ai afishohet në vend të dukshëm, në këndin e njoftimeve të Dhomës, si dhe publikohet në faqen zyrtare të saj.

Neni 11
Pjesëmarrja në programin e detyrueshëm të trajnimit fillestar

1. Çdo person, që plotëson kushtet ligjore sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 9, merr pjesë në programin e trajnimit fillestar për kandidatët për ndërmjetës që zhvillohet nga Dhoma.

2. Dhoma mban gjithë të dhënat e pjesëmarrjes në sesionet trajnuese, duke i pasqyruar të detajuara sipas sesioneve përkatëse. Listat janë të përbëra nga sesioni i paradites dhe i pasdites. Çdo pjesëmarrës është i detyruar që të firmosë praninë e tij për të vërtetuar ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të veprimtarisë në të gjitha sesionet e tij, në rast të kundërt nuk marrin vërtetimin përkatës mbi përfundimin e programit të trajnimit fillestar.

3. Kandidatët për ndërmjetës njoftohen nga Dhoma, në rrugë elektronike, lidhur me

programin mësimor tematik dhe kalendarin e veprimtarive mësimore, të cilat do të ndiqen në mënyrë sistematike prej tyre.

4. Në përfundim të çdo teme mësimore të programit të trajnimit fillestar, kandidatëve për ndërmjetës, u përcillet 1 (një) kopje elektronike e temës respektive dhe një listë sintetike bibliografie (të asaj ku stafi akademik është mbështetur dhe të asaj që sugjerohet për studime të mëtejshme).

Neni 12
Të drejtat dhe detyrimet e kandidatëve për ndërmjetës

1. Kandidatët për ndërmjetës kanë të drejtë:

a) të ndjekin të gjitha veprimtaritë mësimore, që zhvillohen në kuadrin e programit të trajnimit fillestar;

b) të përdorin infrastrukturën, që Dhoma në dispozicion të procesit mësimor, si dhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen nga kjo strukturë;

c) të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e trajnerëve.

2. Kandidatët për ndërmjetës kanë për detyrë:

a) të zbatojnë rregullat e përcaktuara nga Dhoma dhe trajnerët;

b) të respektojnë të drejtat e trajnerëve dhe të kandidatëve të tjerë që ndjekin programin e trajnimit fillestar;

c) të paguajnë tarifat përkatëse për programin e trajnimit fillestar.

Neni 13
Rezultatet e pritura në përfundim të programit të detyrueshëm të trajnimit fillestar

Pas përfundimit të programit të trajnimit fillestar, pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje, ndër të tjera, që:

a) të kuptojnë dhe të kenë përvetësuar aspektet e përgjithshme dhe të posaçme të veprimtarisë së ndërmjetësimit;

b) të njohin parimet e përgjithshme të ndërmjetësit, etikën e ndërmjetësit, rregullat për ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit, si dhe të procedurave disiplinore, të cilave mund t'iu nënshtrohet ndërmjetësi në rast shkeljeje;

c) të ndërmarrin veprime për ndërmjetësimin e mosmarrëveshjeve, si dhe të draftojnë marrëveshjen e ndërmjetësimit dhe deklarata të ndryshme në kuadër të veprimtarisë së ndërmjetësimit;

ç) të dinë të interpretojnë dhe të zbatojnë dispozitat juridike që rregullojnë veprimtarinë e profesionit të ndërmjetësit, si dhe të mosmarrëveshjes që mund të ndërmjetësohet, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 14
Vërtetimi

1. Dhoma, në cilësinë e një prej institucioneve përgjegjëse për trajnimin fillestar për kandidatët për ndërmjetës, dokumenton pjesëmarrjen e këtyre të fundit në trajnimin fillestar.

2. Në fund të programit të trajnimit fillestar, pjesëmarrësit pajisen me vërtetimin përkatës, i cili nënshkruhet nga kryetari i Dhomës.

3. Kryetari i Dhomës përcakton rregulla të posaçme për identifikimin dhe monitorimin e pjesëmarrësve në veprimtaritë trajnuese të programit të trajnimit fillestar, përpara se të lëshojë vërtetimin përkatës.

4. Në vërtetimin përkatës shënohet emri, mbiemri, përfundimi i programit të detyrueshëm të trajnimit fillestar, data e lëshimit dhe numri rendor i vërtetimit, nënshkrimi i kryetarit të Dhomës, vula dhe logoja e Dhomës, si dhe elemente të tjera të nevojshme.

KREU III
TRAJNIMI VAZHDUES

SEKSIONI I
TRAJNIMI VAZHDUES DHE ORGANIZIMI

Neni 15
Organizimi i trajnimit vazhdues

1. Programi i trajnimit vazhdues ofrohet sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10385/2011 dhe rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve organizon programin e trajnimit vazhdues mbi bazën e një planifikimi vjetor dhe pjesëmarrja në të është e detyrueshme për vlefshmërinë e licencës.

3. Dhoma merr masat e nevojshme administrative dhe akademike dhe kujdeset në mënyrë të posaçme për trajnimin vazhdues të ndërmjetësve, duke ofruar programe të trajnimit vazhdues dhe veprimtari të tjera trajnuese.

4. Programi i trajnimeve në trajnimin vazhdues profesional ofron për ndërmjetësit jo më pak se 5 (pesë) ditë trajnime të detyrueshme brenda një viti kalendarik.

5. Programi tematik dhe kalendari i të gjitha veprimtarive që do të zhvillohen në kuadër të trajnimeve vazhduese, së bashku me metodologjinë e trajnimit dhe modelin e formularit të regjistrimit, publikohet elektronikisht në faqen zyrtare të Dhomës.

Neni 16
Programi i trajnimit vazhdues

1. Përmbajtja e programit të trajnimit vazhdues reflekton zhvillimin e kompetencave profesionale të pjesëmarrësve, i cili do të fokusohet në zhvillimin e aftësive praktike dhe vlerat etike të tyre, kryesisht në:

a) ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve profesionale për legjislacionin vendës dhe ndërkombëtar;

b) hartimin e akteve procedurale përkatëse në funksion të ushtrimit të kompetencave, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) aplikimin e rregullave etike;

ç) përshtatjen me rrethana dhe situata të veçanta gjatë ushtrimit të kompetencave;

d) zhvillimin e aftësive në fushën e ndërmjetësimit;

dh) zhvillimin e shkathtësive sociale;

e) zhvillimin e praktikave me institucionet e ndërlidhura me punën e ndërmjetësit;

ë) zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese, organizative dhe menaxhuese.

2. Kompetencat e mësipërme do të zhvillohen nëpërmjet zbatimit të moduleve të trajnimit, trajnimit praktik, si dhe punës praktike që mund të caktohet nga trajnuesit.

3. Programi i trajnimit vazhdues përfshin:

a) trajnime të formimit vazhdues të të gjithë ndërmjetësve aktivë në Republikën e Shqipërisë, anëtarë të Dhomës;

b) trajnime të formimit vazhdues të ndërmjetësve të rinj, që janë anëtarë të Dhomës;

c) trajnime të formimit vazhdues të ndërmjetësve që ushtrojnë veprimtarinë në një fushë të caktuar të së drejtës ose në një zonë gjeografike të caktuar, në bazë të kërkesës, nevojës ose problematikave përkatëse konkrete, që mund të shfaqen ose identifikohen prej tyre;

ç) trajnime informuese për ndërmjetësit, kandidatët për ndërmjetës, si dhe për profesionistët ligjorë/ juristët. Trajnimet informuese nuk vlerësohen në bazë të krediteve.

Neni 17
Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të trajnimeve

1. Trajnimet përcaktohen në fillim të çdo viti kalendarik dhe publikohen në faqen zyrtare të Dhomës. Çdo ndryshim në kalendarin e trajnimeve njoftohet jo më vonë se 1 (një) muaj nga koha e zhvillimit të trajnimit.

2. Trajnimet vazhduese organizohen si trajnim njëditor (në jo më pak se 5 orë/5 kredite) apo si trajnim dyditor i quajtur "cikël trajnimi" (10 orë/10 kredite). Pjesëmarrësit në ciklin e trajnimit u nënshtrohen rregullave specifike të hartuara për një trajnim të tillë.

3. Trajnimet vazhduese mund të organizohen në formën e leksioneve/workshop-eve ose/dhe mënyrave të tjera ndërvepruese dhe tematikat lidhen kryesisht me:

a) legjislacionin në fushën civile, tregtare, të punës dhe familjare, pronësisë intelektuale, të drejtave të konsumatorëve, të mosmarrëveshjeve midis organeve të administratës publike dhe subjekteve private;

b) të drejtat me karakter pasuror, si të drejtat e pronësisë ose të bashkëpronësisë, pjesëtimin e pasurisë, paditë për kërkimin e sendit, paditë mohuese, paditë për pushimin e cenimit të posedimit, mosmarrëveshjet që rrjedhin nga mospërmbushjet e detyrimeve kontraktuese, ato që kanë si objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktues;

c) fushën e së drejtës penale sipas parashikimeve të pikës 3, të neni 2, të ligjit nr. 10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", të ndryshuar, si dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur;

ç) rregullat mbi etikën profesionale të ndërmjetësit;

d) tema të veçanta, që kanë për qëllim përmirësimin e aftësive të ndërmjetësve;

dh) raste studimore nga përvoja e ndërmjetësve, me qëllim identifikimin e rasteve të suksesshme dhe të sfidave që janë hasur.

4. Temat e trajnimeve përcaktohen në bashkëpunim me trajnerin.

5. Për raste të veçanta, nisur nga nevojat e ndërmjetësve për trajnim, të ndryshimeve të legjislacionit dhe problemeve të praktikës, karakteri i programit të trajnimit vazhdues mund të lejojë përfshirjen e veprimtarive trajnuese ose tematikave të tjera.

6. Çdo program trajnimi përmban qëllimin e trajnimit, temën e trajnimit, numrin e moduleve me temat përkatëse, kohëzgjatjen për çdo modul, si dhe çdo element tjetër të nevojshëm për pjesëmarrësit në trajnim. Për trajnimet vazhduese profesionale përcaktohen edhe kreditet përkatëse.

7. Tematikat e trajnimit informues përcaktohen nga Dhoma, duke marrë parasysh edhe kërkesat e ndërmjetësve.

Neni 18
Veprimtari të trajnimit vazhdues, të zhvilluara nga ndërmjetësi

1. Veprimtari të trajnimit vazhdues, që realizohen në mënyrë të pavarur nga ana e ndërmjetësve, janë:

a) pjesëmarrja në konferencë kombëtare ose ndërkombëtare;

b) pjesëmarrja me punim shkencor me tematikë në fushën e ndërmjetësimit në konferencë kombëtare ose ndërkombëtare. Materiali duhet të jetë pjesë e botimit të konferencës;

c) botim i artikullit shkencor me tematikë në fushën e ndërmjetësimit. Artikulli duhet të jetë botuar në revistë shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;

ç) botim i monografive në fushën e ndërmjetësimit;

d) pjesëmarrja dhe angazhimi në veprimtaritë e Dhomës.

2. Veprimtaritë e mësipërme vlerësohen me pikë krediti, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) pjesëmarrja në konferencë kombëtare në fushën e ndërmjetësimit vlerësohet me 10 kredite/2 ditë trajnimi;

b) pjesëmarrja në konferencë ndërkombëtare në fushën e ndërmjetësimit vlerësohet me 15 kredite/3 ditë trajnimi;

c) pjesëmarrja me punim shkencor me tematikë në fushën e ndërmjetësimit në konferencë kombëtare vlerësohet nga 10 në 15 kredite/2 ose 3 ditë trajnimi;

ç) pjesëmarrja me punim shkencor me tematikë në fushën e ndërmjetësimit në konferencë ndërkombëtare vlerësohet me 15 kredite/ 3 ditë trajnimi;

d) botimi i artikullit shkencor me temë në fushën e ndërmjetësimit në revistë shkencore kombëtare vlerësohet me 15 kredite/3 ditë trajnimi;

dh) botimi i artikullit shkencor me temë në fushën e ndërmjetësimit në revistë shkencore ndërkombëtare vlerësohet me 20 kredite/4 ditë trajnimi;

e) botimi i monografive në fushën e ndërmjetësimit vlerësohet me 25 kredite/5 ditë trajnimi;

ë) pjesëmarrja dhe angazhimi në veprimtaritë e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve vlerësohet me jo më pak se 10 kredite/2 ditë trajnimi.

SEKSIONI II
ORGANIZIMI I TRAJNIMIT

Neni 19
Regjistrimi në kurset e trajnimit vazhdues

1. Dhoma njofton ndërmjetësit, në rrugë elektronike, lidhur me programin tematik dhe kalendarin e veprimtarive trajnuese, të cilat do të ndiqen prej tyre.

2. Çdo veprimtari trajnuese publikohet në faqen elektronike të Dhomës dhe përmban të dhëna lidhur me grupin e pjesëmarrësve në të, përmbajtjen narrative ose përshkrimin e kursit, vendin e organizimit të trajnimit, kohëzgjatjen e kursit, datat e parashikuara, llojin, agjendën dhe mbështetjen financiare.

3. Regjistrimi në veprimtaritë trajnuese është individual dhe kryhet sipas modelit të formularit

të regjistrimit, që publikohet në faqen zyrtare të Dhomës.

4. Regjistrimi konsiderohet i vlefshëm nëse është paraqitur ose është kryer jo më vonë se 3 (tri) ditë nga data e zhvillimit të trajnimit përkatës.

5. Dhoma përcakton listën e pjesëmarrësve në çdo sesion trajnues, duke marrë parasysh kërkesat individuale, si dhe referuar përcaktimeve ligjore:

a) jo më pak se 5 (pesë) ditë të plota brenda një viti kalendarik (1 ditë përfshin jo më pak se 5 orë trajnim/5 kredite) dhe jo më pak se 25 (njëzet e pesë) ditë të plota gjatë 5 (pesë) viteve kalendarike); dhe

b) jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë të plota brenda një viti kalendarik dhe 75 (shtatëdhjetë e pesë) ditë të plota gjatë 5 (pesë) viteve kalendarike.

6. Listat e pjesëmarrësve miratohen nga kryetari i Dhomës.

7. Dhoma harton listën e plotë të pjesëmarrësve për të gjithë Republikën, të ndarë sipas kurseve të programit të trajnimit vazhdues.

8. Dhoma, për raste të veçanta dhe përjashtimore, për të mos penguar procesin e trajnimit, nisur nga nevojat për trajnim, mund të përditësojë listat e pjesëmarrësve dhe veprimtarive trajnuese në trajnimin vazhdues.

9. Pas miratimit të listave, Dhoma procedon me njoftimin individual të personave që duhet të marrin pjesë nëpërmjet ftesave elektronike për veprimtarinë/të përkatëse trajnuese.

10. Ftesat për pjesëmarrje në veprimtaritë trajnuese dërgohen në mënyrë elektronike të paktën 1 (një) muaj përpara datës së caktuar për zhvillimin e veprimtarisë. Dhoma kujdeset që të mos krijohen pengesa në frekuentimin e trajnimeve përkatëse.

Neni 20

Pjesëmarrja në veprimtaritë trajnuese të programit vazhdues

1. Dhoma mban gjithë të dhënat e pjesëmarrjes në sesionet trajnuese, të tilla si: listën e të ftuarve në çdo veprimtari, listën e pjesëmarrësve, duke i pasqyruar të detajuara sipas sesioneve përkatëse, si dhe listën e të pajisurve me certifikatë. Listat janë të përbëra nga sesioni i paradites dhe ai i pasdites. Çdo pjesëmarrës është i detyruar që të firmosë praninë e tij, për të vërtetuar ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të veprimtarisë në të gjitha sesionet e tij, në rast të kundërt nuk certifikohet. Kjo listë pasqyrohet edhe në një regjistër të veçantë, nëpërmjet një numri rendor, bazuar në certifikatat e lëshuara.

2. Dhoma mban të dhëna lidhur me fushat e trajnimit, temën e sesionit trajnues, periudhën e veprimtarisë, vendin e zhvillimit, trajnuesit, lehtësuesit, si dhe mbështetjen financiare, nëse ka.

3. Këshilli i Drejtues propozon masat në rastet e mospjesëmarrjes së ndërmjetësit në trajnimet vazhdues, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 10385/2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" dhe i paraqet ato, me shkrim, përpara Bordit Disiplinor.

4. Në përfundim të çdo veprimtarie trajnuese, pjesëmarrësve u përcillet 1 (një) kopje elektronike e temës respektive dhe 1 (një) listë sintetike bibliografie (të asaj ku stafi akademik është mbështetur dhe të asaj që sugjerohet për studime të mëtejshme).

Neni 21

Certifikata

1. Ndërmjetësit që marrin pjesë në trajnimet vazhdues të organizuara nga Dhoma, pajisen me certifikatë, e cila nënshkruhet nga kryetari i Dhomës. Certifikata lëshohet vetëm në rast se ndërmjetësi ka ndjekur të gjitha orët e trajnimit vazhdues.

2. Në certifikatë shënohet emri, mbiemri, titulli i trajnimit, data e zhvillimit të trajnimit, numri i regjistrit, numri i krediteve, nënshkrimi i kryetarit të Dhomës, vula dhe logoja e Dhomës.

3. Pjesëmarrësit e tjerë në trajnimet e Dhomës, si juristët që kanë pasur si synim thellimin e njohurive në fushën e ndërmjetësimit, pajisen me vërtetimin përkatës në përfundim të trajnimit, i cili përmban kohëzgjatjen e trajnimit, tematikën e tij dhe të moduleve përkatëse, si dhe elemente të tjera në varësi të procedurës së zhvillimit të tij.

KREU IV
PËRZGJEDHJA E TRAJNERËVE, TRAJNIMI DHE VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË TYRE

Neni 22
Trajnerët

1. Në trajnimin fillestar dhe në trajnimin vazhdues, si dhe në veprimtari të tjera të organizuara nga Dhoma, angazhohen trajnerë.

2. Lista e trajnerëve dhe dokumentacioni përkatës pasi shqyrtohet nga kryetari, i paraqitet për miratim Këshillit Drejtues të Dhomës në fillim të çdo viti kalendarik.

3. Për përcaktimin e listës së trajnerëve, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve fton publikisht për aplikim të gjithë personat që mendojnë se kanë ekspertizë në një nga fushat dhe temat e programit të trajnimit fillestar dhe atij vazhdues. Dhoma, në varësi të temës së trajnimit do të hulumtojë për gjetjen e trajnerëve më të përshtatshëm dhe mund t'i drejtohet listës së të dhënave mbi trajnerët gjatë trajnimeve të organizuara më parë, bazës së të dhënave të partnerëve të huaj apo OJF-ve të ndryshme me të cilat Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve ka marrëdhënie apo çdo institucioni tjetër që posedon të dhëna të vlefshme që i shërbejnë veprimtarisë së Dhomës.

4. Kandidatët për trajnerë profesionalë në programin e trajnimit fillestar dhe vazhdues duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të kenë përvojë profesionale si ndërmjetës mbi 5 (pesë) vjet ose të kenë përvojë profesionale të specifikuar në fushën për të cilën do jenë trajnerë mbi 7 (shtatë) vjet;

b) të kenë përvojë mësimdhënie akademike.

5. Kritere shtesë të rëndësishme për përzgjedhjen e të gjithë trajnerëve, të cilët duhet të konkurrojnë në mënyrë kumulative me kriteret e mësipërme, janë si më poshtë:

a) integriteti moral dhe reputacioni i mirë në detyrën e tyre, i cili ka të bëjë me respektimin e vazhdueshëm të rregullave në detyrën e tij/saj;

b) aftësi të larta në komunikim;

c) veprimtaria shkencore në formën e botimeve dhe konferencave;

ç) të ketë aftësitë e nevojshme për të vlerësuar nevojat për trajnimin profesional të ndërmjetësve;

d) të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze; përbën epërsi në përzgjedhje zotërimi edhe i gjuhëve të huaja të tjera;

dh) aftësi të prezantimit dhe të transmetimit të saktë dhe të qartë të informacionit te pjesëmarrësit.

6. Aplikimi bëhet duke paraqitur dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kritereve të mësipërme, të shoqëruar nga një:

a) kërkesë zyrtare në format fizik ose elektronik;

b) një kopje të jetëshkrimit, duke specifikuar përvojën dhe trajnimet e marra, pjesëmarrjen në konferenca ose botime, të vërtetuara me dokumentet përkatëse;

c) titullin e temës, çështjes ose nënçështjes për të cilën kërkojnë të japin ekspertizën e tyre;

ç) metodologjinë që do të përdorin në trajnim;

d) projektprogramin e detajuar sipas nenit 24, të kësaj rregulloreje.

7. Për zhvillimin e trajnimeve, Dhoma nënshkruan me trajnerët kontratë shërbimi, në të cilat përcaktohen të drejtat e detyrimet reciproke.

8. Në sesionet e trajnimit mund të përdoren edhe lehtësues për të mbështetur punën e trajnuesve, me qëllim nxjerrjen e literaturës ose seleksionimin e rasteve të praktikës gjyqësore të nevojshme për trajnim.

9. Dhoma përcakton listën e lehtësuesve për çdo sesion trajnues. Lista hartohet mbi bazën e aplikimeve nga radhët e ndërmjetësve, të spikatur në pjesëmarrjen aktive të sesioneve trajnuese dhe me aftësi studimore. Detyrat e lehtësuesve përcaktohen në marrëveshje midis tyre dhe Dhomës.

10. Tarifa e pagesës për çdo trajner propozohet nga Këshilli Drejtues dhe miratohen nga Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve.

Neni 23
Detyrimet e përgjithshme të trajnerëve

1. Trajnerët duhet të marrin përsipër përmbushjen e detyrimeve të mëposhtme:

a) ushtrimin e funksionit të tyre objektivisht dhe paanësisht, në përputhje me ligjin, këtë

rregullore dhe aktet e tjera, pa u ndikuar nga trysnia dhe ndikimet e ndonjë lloji;

b) orientimi i trajnimit, duke u nisur nga natyra praktike e trajnimit fillestar e vazhdues;

c) respektimi i vendimeve të Dhomës;

ç) respektimi i orareve të veprimtarive trajnuese;

d) në zbatimin e veprimtarive të tyre, nuk duhet të ndikohen nga ndonjë doktrinë politike. Ata nuk mund të përdorin veprimtaritë e tyre pedagogjike për të shprehur bindjet e tyre politike;

dh) të ushtrojnë me kompetencë dhe me korrektësi detyrat e tyre profesionale, të respektojnë përgjegjësitë e tyre në bazë të kësaj rregulloreje dhe vendimeve të Dhomës;

e) mospërhapja ose mospërdorimi i informacionit, që mësojnë gjatë punës së tyre për ndonjë qëllim tjetër nga ai që lidhet me përgjegjësitë e tyre trajnuese;

ë) promovimi i sundimit të ligjit, shtetit të së drejtës, mbrojtja e të drejtave dhe lirive të shtetasve.

Neni 24
Detyrimet specifike të trajnerëve

1. Trajnerët e trajnimit vazhdues duhet të plotësojnë detyrimet specifike të mëposhtme:

a) të depozitojnë pranë Dhomës një projektprogram të detajuar në kopje fizike dhe elektronike, ku në mënyrë specifike të jepet një përshkrim i çështjeve të trajnimit ose modulit për të cilin është zgjedhur, literatura që do të përdoret, duke përfshirë një listë sintetike bibliografie (të asaj ku janë mbështetur dhe të asaj që sugjerohet për studime të mëtejshme), sipas rastit, si dhe bazën ligjore që pjesëmarrësit duhet të disponojnë gjatë trajnimit;

b) duhet të njoftojnë Dhomën për çdo pamundësi pjesëmarrjeje jo më vonë se 1 (një) muaj nga dita e trajnimit, me përjashtim të rasteve të paparashikueshme. Në një rast të tillë, trajnerët duhet të rekomandojnë trajnerin zëvendësues të mundshëm, duke pasur në konsideratë standardet e Dhomës, si dhe duhet të vënë në dispozicion punën parapërgatitore;

c) të mbajnë shënime gjatë veprimtarisë trajnuese lidhur me: sugjerime dhe vërejtje të audiencës mbi tematikën aktuale dhe perspektive të trajnimit; sugjerime për modifikime e ndryshime në legjislacion, të dala nga seancat "Diskutime dhe debat"; pjesëmarrjen në trajnime; aftësinë e pjesëmarrësve për t'u përqendruar brenda tematikës së trajnimit;

ç) të gjitha këto dhe të tjera, që lidhen me trajnimin vazhdues, do t'i paraqesin në një "relacion" pranë Dhomës, jo më vonë se 2 (dy) javë pas trajnimit.

Neni 25
Metodologjia e trajnimit

1. Për metodologjinë e trajnimit, trajnerët që angazhohen pranë Dhomës, duhet:

a) të zhvillojnë një metodë ndërvepruese mësimdhënieje;

b) të bëjnë përpjekje për të ruajtur një ekuilibër mes trajtimit teorik dhe praktik të çështjeve që janë objekt diskutimi, ku prioritet të kenë aspektet praktike;

c) të kujdesen për ndërhyrje konstruktive, të shpërndara dhe jodominuese, duke i lënë hapësirë të bollshme diskutimeve nga pjesëmarrësit;

ç) të kenë aftësinë për të kombinuar disa metoda të trajnimit (prezantimi verbal, prezantim me shkrim, puna në grup, pyetjet, përdorimin e mjeteve audiovizive etj.);

d) të kenë aftësi për të prezantuar materialin pa ndonjë mbështetje dokumentare dhe për të përgatitur materialet burimore të nevojshme, mbështetjen e aspekteve teorike dhe praktike, për të vëzhguar nivelin e duhur të ndërveprimit dhe mbështetjen e metodave të trajnimit, qëllimit dhe tematikës së prezantimeve dhe për të qëndruar brenda kohës së përcaktuar për një prezantim;

dh) të bashkëpunojnë me trajnerët e tjerë që janë të përfshirë në të njëjtin trajnim apo tematikë.

2. Trajnimet organizohen në dy pjesë, pjesa teorike dhe pjesa praktike e së njëjtës lëndë. Kjo ndarje është përcaktuese edhe për metodologjinë e mësimdhënies. Metodologjia në fjalë përfshin metodën tradicionale të ligjërimit (përfshirë edhe metodën e simulimit dhe të zgjidhjes së problemeve). Metodologjia e mësimdhënies konsiston në kombinimin e punës teorike me aspektet praktike. Pjesa më e madhe e këtyre seancave praktike kërkojnë që pjesëmarrësit të

shkruajnë, të draftojnë ose të përgatisin marrëveshje për zgjidhjen e konflikteve me ndërmjetësim ose deklarata të ndryshme. Pjesa më e madhe e tyre do të jenë të natyrës intensive praktike dhe të tjerat do të jenë të organizuara sipas temave përkatëse.

3. Trajnerët mund të thirren në mënyrë periodike nga Dhoma për të bashkëpunuar dhe për të diskutuar lidhur me mbarëvajtjen e mësimdhënies, si dhe masat që mund të ndërmerren në kuadër të garantimit të cilësisë dhe efektivitetit të mësimdhënies.

Neni 26
Vlerësimi i punës së trajnerëve

1. Trajnerët, që angazhohen pranë Dhomës, i nënshtrohen një procesi vlerësimi, me qëllim monitorimin e punës së tyre dhe garantimin e cilësisë së mësimdhënies për pjesëmarrësit.

2. Vlerësimi i trajnerëve bëhet pas secilit trajnim që ata u ofrojnë pjesëmarrësve me anë të formularit të vlerësimit të trajnerëve, që do t'i shpërndahet secilit pjesëmarrës në fund të trajnimit, duke respektuar anonimatin e tyre. Formulari i vlerësimit të trajnerëve plotësohet në 2 (dy) kopje, një për trajnerin dhe një që do t'i dorëzohet kryetarit të Dhomës dhe do të jetë formular standard për të gjithë trajnerët dhe trajnimet.

3. Vlerësimi përfshin tre përbërës kryesorë:

a) qartësia e përmbajtjes së materialeve të trajnimit të shpërndarë për pjesëmarrësit;

b) kompetenca e trajnerit;

c) ushtrimet praktike të aftësive/ koncepteve të shpjeguara.

4. Këshilli Drejtues përgatit një raport mbi rezultatet e vlerësimit të trajnerëve, së bashku me propozimet për marrjen ose jo të masave për largimin e atyre që nuk plotësojnë kriteret, të cilin ia paraqet për miratim Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve. Nëse trajneri merr vlerësim negativ nga të paktën 75% e pjesëmarrësve, ai e humbet të drejtën për të trajnuar dhe largohet.

Neni 27
Trajnimi i trajnerëve

1. Trajnerëve iu ofrohet një trajnim nga Dhoma, që ka si qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive të tyre akademike dhe praktike në fushën e ndërmjetësimit. Ky trajnim garanton që trajnuesi ka të gjitha njohuritë, aftësitë dhe kompetencat për të ofruar module ose lëndë të lidhura me ndërmjetësimin.

2. Programi i trajnimit të trajnerëve (TOT) është i vlefshëm nëse përfshin:

a) procesin e të mësuarit;

b) parimet e të mësuarit të të rriturve;

c) hartimin dhe planifikimin e një seance trajnimi;

ç) zhvillimin e objektivave të të nxënit, teknikat dhe metodat e lehtësimit të trajnimit.

KREU V
RREGULLAT E PËRBASHKËTA MBI ORGANIZIMIN E TRAJNIMEVE

Neni 28
Vendi i zhvillimit të trajnimeve

Trajnimi fillestar dhe trajnimet vazhduese organizohen në mjediset të cilat mund të kontraktohen nga Dhoma, me qëllim zhvillimin e trajnimeve përkatëse dhe garantimin e aksesit të të gjithë personave të konfirmuar për pjesëmarrje.

Neni 29
Regjistrat

1. Dhoma krijon dhe administron regjistrat e të dhënave për programin e trajnimit fillestar dhe vazhdues dhe 1 (një) kopje e tyre i përcillet ministrit të Drejtësisë deri më 31 janar të vitit pasardhës.

2. Regjistrat përmbajnë të dhëna personale dhe profesionale për të gjithë pjesëmarrësit në trajnimin fillestar dhe vazhdues. Të dhënat personale mbahen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Për të gjithë kandidatët për ndërmjetës, që marrin pjesë në trajnimin fillestar, si dhe ndërmjetësit që marrin pjesë në trajnimin vazhdues krijohet një dosje individuale, në të

cilën do të dokumentohen të dhënat përkatëse mbi regjistrimin në trajnimin fillestar, si dhe për pjesëmarrjen në veprimtaritë trajnuese.

Neni 30
Financimi, fondet dhe të ardhurat

1. Programi i trajnimit fillestar dhe programi i trajnimit vazhdues mbështeten financiarisht nga të ardhurat e anëtarëve të Dhomës, të ardhurat nga tarifat e regjistrimit, si dhe nga Dhoma. Tarifat e trajnimit fillestar dhe trajnimeve vazhduese propozohen nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve dhe miratohen nga Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve.

2. Trajnimi fillestar dhe trajnimet vazhduese mund të financohen edhe nga donatorë të ndryshëm, shqiptarë ose të huaj, në kuadër të projekteve të ndryshme zhvillimi ose nga donacionet apo grandet e ofruara nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare. Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve bën njoftimet përkatëse ndaj ndërmjetësve ose kandidatëve ndërmjetës, të cilët paraqesin interes për të qenë pjesë e këtyre trajnimeve.

ANEKS 1
MODULET E PROGRAMIT TË DETYRUESHËM TË TRAJNIMIT FILLESTAR

Kurrikula e formimit fillestar të detyrueshëm përmban minimalisht modulet e mëposhtme kurrikulare:

Nr.	Emërtimi i modulit
1	Ndërmjetësimi në botë dhe Evropë (praktikat dhe modelet më të mira etj.)
2	Ndërmjetësimi në Shqipëri (aspekte të përgjithshme, procedura dhe parimet e ndërmjetësimit, ndërmjetësi përballë klientëve, të drejtat dhe detyrimet e ndërmjetësit, konflikti i interesit, ndërmjetësi dhe institucioni referues etj.)
3	Mbikëqyrja dhe procedimi disiplinor, procedura, shkeljet dhe masat disiplinore, të drejtat dhe detyrimet e subjektit që i nënshtrohet procedimit disiplinor etj.
4	Organizimi dhe funksionimi i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve
5	E drejta civile (të drejtat me karakter pasuror si të drejtat e pronësisë ose të bashkëpronësisë, pjesëtimin e pasurisë, paditë për kërkimin e sendit, për paditë mohuese e për paditë për pushimin e cenimit të posedimit)
6	E drejta civile (mosmarrëveshjet që rrjedhin nga mospërmbushjet e detyrimeve kontraktuese, ato që kanë si objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktues)
7	E drejta tregtare
8	E drejta e punës
9	E drejta familjare
10	Pronësisë intelektuale
11	Të drejtat e konsumatorëve
12	Mosmarrëveshjet midis organeve të administratës publike dhe subjekteve private
13	E drejta penale dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur
14	Etika profesionale
15	Standardet dhe legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar mbi ndërmjetësimin
16	Mënyra e referimit të rasteve për ndërmjetësim dhe efektet e një marrëveshjeje ndërmjetësimi
17	Sistemi i zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve dhe dallimeve ndërmjet metodave të ndryshme të negocimit
18	Menaxhimi i konfliktit dhe i mosmarrëveshjeve, shkaqet dhe motivet e situatave konfliktuale
19	Dallimet ndërmjet pozicioneve, nevojave dhe interesave
20	Inteligjenca emocionale dhe menaxhimi i emocioneve dhe i palëve

URDHËR
Nr. 90, datë 23.2.2021

PËR MIRATIMIN E "RREGULLORES SË PROVIMIT TË KUALIFIKIMIT PËR PROFESIONIN E NDËRMJETËSIT"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, pikave 3 dhe 5, të nenit 5/1, të ligjit nr. 10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e "Rregullores së provimit të kualifikimit për profesionin e ndërmjetësit", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

RREGULLORE
E PROVIMIT TË KUALIFIKIMIT PËR PROFESIONIN E NDËRMJETËSIT

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat e përgjithshme për provimin e kualifikimit, që kryhet nga kandidati për ndërmjetës pas përfundimit të formimit fillestar.

2. Kjo rregullore përcakton rregulla mbi mënyrën e organizimit, përgatitjen, përmbajtjen dhe vlerësimin e provimit të kualifikimit, i cili organizohet nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve dhe bazohet në procedura transparente, metoda vlerësimi të drejta dhe të besueshme dhe në një nivel të lartë të njohurive profesionale të kandidatëve.

3. Kandidatët për ndërmjetës, të cilët kanë përfunduar programin e trajnimit fillestar, si dhe që përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 5, pika 1, germat "a", "b", "b/1", dhe "c", të ligjit nr. 10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", i ndryshuar, kanë të drejtë të regjistrohen dhe të marrin pjesë në provimin për kualifikim për ndërmjetës.

4. Provimi i kualifikimit organizohet të paktën 1 (një) herë në vit nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve. Ministri i Drejtësisë përcakton me urdhër ditën, orën, vendin e zhvillimit të provimit të kualifikimit, afatet e paraqitjes së kërkesave për shprehje interesi për të hyrë në provim dhe dokumentet përkatëse që duhet të shoqërojnë kërkesën.

5. Provimi i kualifikimit përbëhet nga pjesa e kontrollit të njohurive me shkrim dhe me gojë.

6. Urdhri i ministrit të Drejtësisë, sipas pikës 4, të kësaj rregulloreje, publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, të paktën 45 (dyzetë e pesë) ditë para ditës së organizimit të provimit me shkrim.

7. Në rast se kërkohet nga personat e interesuar për të marrë pjesë në provimin e kualifikimit, nëpunësit e strukturave përgjegjëse për profesionet e lira pranë Ministrisë së Drejtësisë janë të detyruar t'u vënë në dispozicion 1 (një) kopje të urdhrit dhe t'i sqarojnë e orientojnë lidhur me kushtet ligjore që duhen plotësuar dhe afatet përkatëse.

8. Pas publikimit të urdhrit të ministrit të Drejtësisë, që përcakton datën e organizimit të provimit, personat që dëshirojnë të marrin pjesë në provimin e kualifikimit paraqesin në Ministrinë e Drejtësisë një kërkesë për shprehje interesi, si dhe dokumentacionin përkatës që vërteton se i plotësojnë të gjitha kushtet e parashikuara nga legjislacioni për të marrë pjesë në provim.

9. Kërkesa e shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm duhet të paraqitet jo më vonë se 21 (njëzet e një) ditë përpara ditës së organizimit të provimit.

10. Struktura përgjegjëse për profesionet e lira në Ministrinë e Drejtësisë organizon punën për regjistrimin e kërkesave dhe informon të interesuarit lidhur me kushtet e organizimit të provimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për pjesëmarrje.

11. Lista paraprake e kandidatëve të kualifikuar, për të marrë pjesë në provim, si dhe lista paraprake e kandidatëve të skualifikuar publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve jo më vonë se 14 (katërmbëdhjetë) ditë para ditës së organizimit të provimit. Struktura përgjegjëse për profesionet e lira në Ministrinë e Drejtësisë i njofton çdo personi, nëpërmjet postës elektronike, shkaqet për përfshirjen në listën paraprake të kandidatëve të skualifikuar.

12. Personat, të cilët janë renditur në listën paraprake të kandidatëve të skualifikuar, për shkak se nuk plotësojnë kushtet ligjore për të marrë pjesë në provimin e kualifikimit, mund të paraqesin një ankim pranë ministrit të Drejtësisë, duke i bashkëlidhur dokumentacionin që provon përmbushjen e kritereve ligjore, brenda 3 (tri) ditëve nga dita e publikimit të listave, sipas pikës 11, të kësaj rregulloreje.

13. Struktura përgjegjëse për profesionet e lira shqyrton ankimin e paraqitur dhe i propozon ministrit të Drejtësisë përfshirjen në listën e kandidatëve të kualifikuar, në rastet kur provohet përmbushja e kritereve ligjore për të marrë pjesë në provim ose skualifikimin e tij nga pjesëmarrja në provim. Shqyrtimi i ankimit, si dhe marrja e vendimit nga ministri, kryhet jo më vonë se 2 (dy) ditë nga data e paraqitjes së ankimit. Ndaj urdhrit të ministrit për skualifikimin e kandidatit mund të paraqitet padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

14. Struktura përgjegjëse për profesionet e lira përgatit edhe urdhrin e ministrit për skualifikimin e çdo kandidati, që sipas pikës 12 është renditur në listën paraprake të kandidatëve të skualifikuar dhe që nuk kanë paraqitur një ankim. Urdhri i ministrit për skualifikimin e çdo kandidati i njoftohet kandidatëve të skualifikuar, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative. Ndaj urdhrit të ministrit për skualifikimin e kandidatit mund të paraqitet padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

15. Lista përfundimtare e kandidatëve të kualifikuar për provim publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para ditës së organizimit të provimit.

16. Kandidatët do të paraqiten për të marrë pjesë në kontrollin e njohurive me shkrim në ditën, orën dhe vendin e caktuar në urdhrin e ministrit të Drejtësisë.

17. Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit ngrihet me urdhër të ministrit të Drejtësisë dhe përbëhet nga 2 (dy) përfaqësues të propozuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve dhe 3 (tre) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë. Komisioni është i përkohshëm dhe është përgjegjës, për:

a) hartimin e tezave të provimeve me shkrim dhe me gojë dhe përgjigjeve të tyre, duke thirrur për bashkëpunim trajnerët e trajnimit fillestar dhe vazhdues, si dhe ekspertë ose pedagogë të brendshëm të institucioneve të arsimit të lartë, të fushave për të cilat do të testohen kandidatët. Trajneri, eksperti ose pedagogu përgatisin bankën e pyetjeve për fushën përkatëse për të cilën janë specializuar dhe përgjigjen për secilën pyetje, e cila do të shërbejë për vlerësimin e përgjigjeve të provimeve të kandidatëve për ndërmjetës. Anëtarët e Komisionit, trajnerët, ekspertët dhe pedagogët para zhvillimit të provimit nënshkruajnë deklaratë personale se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me të interesuarit e kualifikuar, që marrin pjesë në provim;

b) identifikimin e kandidatëve pjesëmarrës në provim, shpërndarjen në mënyrë rastësore të tyre në mjediset ku do të zhvillohet provimi, përzgjedhjen dhe shpërndarjen e tezave, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e provimit, përcaktimin e listës emërore të personave që morën pjesë në provim;

c) vlerësimin me pikë të përgjigjeve në provimin me shkrim dhe me gojë të dhëna nga kandidatët në raport me përgjigjet e parapërgatitura nga hartuesit e bankës së pyetjeve;

ç) shqyrtimin e ankimeve nga kandidatët ndaj rezultateve të publikuara;

d) shpalljen e rezultateve përfundimtare për kandidatët që kalojnë me sukses provimin e kualifikimit dhe renditjen e tyre në përputhje me rezultatet e provimit të kualifikimit;

dh) mbajtjen dhe evidentimin e gjithë dokumentacionit që lidhet me provimin e kualifikimit.

18. Hyrja për në mjediset e brendshme të zhvillimit të provimit me shkrim do të bëhet 1 (një) orë përpara orarit të njoftuar për provimin.

19. Identifikimi i kandidatëve bëhet në bazë të një dokumenti identifikimi personal të vlefshëm dhe me fotografi, i cili mund të jetë letërnjoftim ose pasaportë.

20. Kandidatët, që nuk kanë mjet identifikimi të vlefshëm, përjashtohen nga pjesëmarrja në provimin me shkrim.

21. Kandidatët ftohen të zënë vendet sipas një përzgjedhjeje rastësore të caktuar nga anëtarët e Komisionit dhe, për asnjë arsye, nuk mund të ndryshojnë vendin e caktuar. Kandidati nuk lejohet të dalë jashtë, si dhe asnjë person i paautorizuar nuk lejohet të futet në sallën e provimit, përfshirë këtu edhe kandidatët të cilët janë paraqitur jashtë afatit të përcaktuar për hyrjen në sallë.

22. Pasi është kryer identifikimi i kandidatëve, udhëzohen të deklarojnë nëse janë apo jo të pajisur me mjete të tilla, si: çantë, dosje, laps ose stilolaps, mjete elektronike ose telefonike, të cilat nuk lejohen në sallën e provimit. Nëse kandidatët janë të pajisur me mjete të tilla, duhet t'i dorëzojnë për ruajtje të gjitha këto sende pranë punonjësve të caktuar për këtë qëllim.

23. Kandidatëve u shpërndahen baza materiale e nevojshme për kryerjen e provimit dhe kopje të parapërgatitura të testit, të cilat kanë në çdo fletë nënshkrimin e kryetarit të Komisionit Mbikëqyrjes dhe Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve dhe kodin e provimit. Kodi i provimit do të jetë një numër me dy ose më tepër shifra dhe unik për çdo kopje të testit dhe për çdo kandidat, i cili do të përdoret gjatë gjithë procesit të zhvillimit të provimit të kualifikimit.

24. Pas shpërndarjes së testit, kandidatëve u kalohet një listë me emrat e tyre dhe secili shënon kodin e testit përbri emrit të vet. Pas përfundimit të shënimit të kodeve nga të gjithë konkurrentët, lista mbyllet në një zarf të veçantë, për t'u hapur nga Komisionit i Mbikëqyrjes dhe Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve pas mbarimit të procesit të vlerësimeve të përgjigjeve për të gjitha testet.

25. Përpara fillimit të provimit, kandidatët vihen në dijeni, për:

a) kohën brenda së cilës duhet të përfundojnë dhënien e përgjigjeve, e cila gjendet e përcaktuar në tezën e provimit;

b) udhëzohen që të mos komunikojnë mes tyre ose me persona jashtë mjedisit ku organizohet provimi;

c) udhëzohen të mos shënojnë ose lënë emrin, të bëjnë shenja sado të vogla, shprehje apo citime në tezën e provimit, të cilat mund ta bëjnë aplikantin të identifikueshëm;

ç) të mbajnë qetësi;

d) të mos konsultohen me libra ose materiale të tjera të shkruara;

dh) mënyrën e komunikimit me anëtarët e Komisionit, në rast nevoje, e cila duhet të jetë me zë të ulët dhe duke e thirrur në vendin e zhvillimit të provimit;

e) përzgjedhjen e zarfit të tezës me zgjedhje rastësore përpara auditorit;

ë) u jepen udhëzime e sqarime të tjera të rastit, e vihen në dijeni për pasojat, në rast se nuk i respektojnë kërkesat e parashtruara.

Pas njoftimit mbi rregullat e provimit, konkurrenti ftohet të plotësojë një deklaratë me shkrim, se u njoh me rregullat dhe i pranon ato, si dhe se është i ndërgjegjshëm se shkelja e tyre përbën shkak për skualifikimin e menjëhershëm nga provimi. Refuzimi për nënshkrimin e deklarimit, apo kundërshtimi i përmbajtjes së tij, sjell humbjen e menjëhershme të së drejtës për të kryer provimin.

26. Pyetjet e provimit do t'i referohen legjislacionit që zbatohet në ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit, duke synuar testimin e njohurive dhe të aftësive të kandidatit në fushat e veprimtarisë së ndërmjetësimit dhe zgjidhjen e rasteve konkrete.

27. Provimi i kualifikimit mbulon të gjitha lëndët e zhvilluara sipas programit të formimit fillestar të detyrueshëm, të cilit i nënshtrohet kandidati.

28. Provimi përbëhet nga pjesa teorike dhe nga pjesa praktike mbi temat e trajtuara në trajnimin fillestar në fushën civile, tregtare, të punës dhe familjare, pronësisë intelektuale, të drejtave të konsumatorëve, të mosmarrëveshjeve midis organeve të administratës publike dhe subjekteve private, të drejtave me karakter pasuror, si të drejtat e pronësisë ose të bashkëpronësisë, pjesëtimin e pasurisë, paditë për kërkimin e sendit, për paditë mohuese e për paditë për pushimin e cenimit të posedimit, mosmarrëveshjet që rrjedhin nga mospërmbushjet e detyrimeve kontraktuese, ato që kanë si objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktues dhe fushës së të drejtës penale, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 2, të ligjit, si dhe nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur.

29. Tezat e provimit me shkrim dhe pyetjet e provimit me gojë përgatiten nga Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve jo më herët se 1 (një) ditë para datës së organizimit dhe nuk duhet t'u bëhen të ditura personave të tjerë. Pyetjet e provimit me shkrim hartohen në disa teste të ndryshme, të cilat futen në zarfe të ndryshme, prej të cilëve një do të zgjidhet për t'u aplikuar në provim. Të gjitha zarfet duhet të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve.

30. Zgjedhja e zarfit do të bëhet me short, ditën që do të organizohet provimi dhe në prani të kandidatëve. Zarfi duhet të jetë i mbyllur dhe i nënshkruar, në të kundërtën, teza në të është e pavlefshme dhe zëvendësohet me një zarf tjetër të mbyllur. Pas përzgjedhjes, zarfi hapet nga Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve dhe teza e përzgjedhur u bëhet e ditur publikisht kandidatëve nga kryetari i Komisionit. Në një zarf tjetër të mbyllur, ndodhen brenda përgjigjet e testit në 2 (dy) kopje dhe hapet kur të përfundojë koha e provimit.

31. Teza e provimit përmban pyetje me alternativa. Për plotësimin e saj, kandidati rrethon saktë vetëm njërën prej tyre. Korrigjimi i mëvonshëm apo shënimi i më shumë se një alternative për secilën pyetje e bën përgjigjen automatikisht të pasaktë. Fletët e përgjigjes së testimit do të jenë të gjitha të vulosura në pjesën e pasme.

32. Teza e provimit korrigjohet nëpërmjet sistemeve elektronike, që garantojnë vlerësimin automatik të përgjigjeve.

33. Gjatë plotësimit të tezës së provimit nuk lejohen nënvizime apo shenja të tjera, si edhe nuk duhet të përdoren baza të tjera materiale, veç atyre të vëna në dispozicion sipas pikës 23, të kësaj rregulloreje.

34. Kandidati, që gjatë provimit nuk i respekton udhëzimet e dhëna sipas kësaj rregulloreje, njoftohet pa paralajmërim të ndërpresë provimin dhe të lërë menjëherë sallën e provimit, duke i komunikuar edhe skualifikimin nga procedura e provimit.

35. Kandidati i skualifikuar, sipas pikës 34, të kësaj rregulloreje, barazohet me kandidatët që nuk e kanë marrë minimumin e nevojshëm të pikëve për t'u kualifikuar. Në këtë rast, përkrah emrit të personit bëhet shënimi "Skualifikohet", vihet në dijeni kryetari i Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve dhe bëhet pasqyrimi përkatës në procesverbalin e provimit, ku shënohet nxjerrja jashtë procesit të vlerësimit të tezës së kandidatit të skualifikuar, si dhe shkaqet që kanë çuar në skualifikimin e kandidatit.

36. Procesverbali i provimit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve dhe bëhet pjesë e dosjes mbi procedurat e zhvilluara duke i bashkëlidhur edhe tezat e kandidatëve të skualifikuar.

37. Pas përfundimit të kohës së caktuar për provimin, bëhet mbledhja e përgjigjeve të tezave të kandidatëve, si dhe të gjitha materialet e tjera të përdorura në provim dhe, nëse është rasti, bëhen shënimet përkatëse sipas parashikimeve të mësipërme.

38. Pasi janë dorëzuar testet për vlerësim automatik, hapet zarfi me përgjigjet e testit dhe 1 (një) kopje e përgjigjeve administrohet nga Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve, ndërsa 1 (një) kopje tjetër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

39. Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve administron rezultatet e dala nga vlerësimi automatik i tezave dhe përllogarit shumën e pikëve të fituara nga

kontrolli i njohurive me shkrim për çdo tezë provimi. Administrimi i rezultateve të përfituara nga korrigjimi automatik dokumentohet me procesverbal nga një prej anëtarëve të Komisionit, që zgjidhet nga kryetari. Anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve në mbledhje.

40. Vlerësimi i provimit të kualifikimit bëhet me maksimumin e mundshëm 100 (njëqind) pikë, nga të cilat kontrolli i njohurive me shkrim përbën 75% të numrit të përgjithshëm të pikëve (75 pikë) dhe kontrolli i njohurive me gojë përbën 25% të numrit total të pikëve (25 pikë).

41. Testet e vlerësuara automatikisht nënshkruhen në çdo fletë nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve. Rezultatet e përgjigjeve të përfituara nga sistemi elektronik i vlerësimit për çdo test pasqyrohen në një listë, e cila përmban kodin dhe përbri pikët vlerësuese. Lista nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Pas nënshkrimit të listës me kodet dhe pikët e vlerësimit për testet përkatëse, hapet zarfi me emrat dhe kodet e kandidatëve dhe përbri emrit dhe kodit të çdo kandidati shënohen pikët e fituara.

42. Lista me emrat, kodet dhe pikët e fituara nga kandidatët nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve. Një kopje e saj, e cila përmban vetëm kodet dhe pikët e fituara nga kandidatët, publikohet brenda ditës në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve. Për efekt ankimi, publikimi është i barasvlershëm me njoftimin e çdo kandidati.

43. Kandidatët, që kanë vërejtje për vlerësimin, kanë të drejtë të ankohen brenda 3 (tri) ditëve nga dita e afishimit të listës. Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve shqyrton ankimet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas kalimit të këtij afati dhe vë në dijeni ankuesin mbi shqyrtimin e ankimit.

44. Kandidati që vlerësohet me të paktën 55 (pesëdhjetë e pesë) pikë në provimin me shkrim kalon në kontrollin e njohurive me gojë.

45. Provimi me gojë, i cili është i hapur për publikun, zhvillohet jo më vonë se 2 (dy) javë pas provimit me shkrim përpara Komisionit të provimit. Provimi me gojë regjistrohet nëpërmjet mjeteve audio ose audiovizive, përveç rasteve kur kandidatët shprehimisht kërkojnë që provimi me gojë të mos jetë i regjistruar.

46. Menjëherë pas përfundimit të provimit me gojë, anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit për Ndërmjetës japin vlerësimin e tyre në lidhje me rezultatet e secilit kandidat, në mbledhje me dyer të mbyllura, duke përllogaritur shumën e pikëve të përgjithshme të fituara nga kontrolli i njohurive me shkrim dhe me gojë. Anëtarët e Komisionit votojnë për vlerësimin me pikë. Anëtarët e Komisionit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve dhe të votimit në mbledhje.

47. Lista me emrat, kodet dhe pikët e fituara për secilin kandidat nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe i bashkëlidhet procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve.

48. Kandidati që ka kaluar provimin me shkrim dhe me gojë dhe që vlerësohet në total me pikët më të larta në renditje, por jo më pak se 80% të pikëve, konsiderohet fitues. Kandidatët që kalojnë me sukses provimin e kualifikimit, renditen në përputhje me rezultatet e provimit të kualifikimit. Lista me kodet dhe pikët e fituara për secilin kandidat publikohet në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

49. Për marrjen e vendimit për përllogaritjen e pikëve të përgjithshme për çdo kandidat, mbahet procesverbal nga një prej anëtarëve të Komisionit, që zgjidhet nga kryetari. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve, përfshirë edhe ata që nuk pajtohen me vendimin. Anëtari, që nuk pajtohet me qëndrimin e shumicës, e nënshkruan procesverbalin me shënimin "Nuk pajtohem me vendimin. Bashkëlidhur paraqes mendimin tim". Anëtari në pakicë paraqet veçmas, me shkrim, mendimin e tij dhe pasi nënshkruhet nga hartuesi, i bashkëlidhet procesverbalit. Në rast se anëtari i Komisionit, i cili ka mendim të kundërt me shumicën, nuk përgatit mendimin e tij me

shkrim si më lart, kundërshtimi i tij konsiderohet i paqenë.

50. Kandidatët që kanë vërejtje për vlerësimin e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve, që kanë kërkuar regjistrimin me mjete elektronike të provimit me gojë, kanë të drejtën e ankimit brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni për rezultatet e provimit.

51. Pas shqyrtimit të ankimeve dhe njoftimit të kandidatëve që kanë paraqitur ankimet, Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve përgatit listën me emrat, kodet dhe pikët e fituara për secilin kandidat, e cila nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e tij. Lista i bashkëlidhet procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve. Një kopje e listës përfundimtare me kodet dhe me pikët e fituara për secilin kandidat publikohet në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

52. Procesverbalet, përgjigjet e tezës të dhëna nga kandidatët, tezat e skualifikuara, si dhe gjithë dokumentacioni tjetër që krijohet dhe i përket procesit të organizimit të provimit, shpalljes së rezultateve dhe të kandidatëve që kalojnë me sukses provimin, ruhen në arkivin e Ministrisë së Drejtësisë, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.

53. Kandidatët që kalojnë me sukses provimin e kualifikimit kanë të drejtë të paraqesin dokumentacionin për pajisjen me licencën e ndërmjetësit pranë ministrit të Drejtësisë dhe të regjistrohen në Regjistrin e Ndërmjetësve pranë Ministrisë së Drejtësisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", i ndryshuar.

VENDIM
Nr. 37, datë 11.2.2021

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË F TL SHA, PËR SHTYRJEN E HYRJES NË FUQI TË VENDIMIT NR. 202, DATË 2.12.2020, PËR MIRATIMIN E "RREGULLORES PËR PROCEDURAT E SHITJES SË TEPRICAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË TREGUN E PARREGULLUAR PËR SHOQËRINË PUBLIKE TË FURNIZIMIT"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 104, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të nenit 11, pikat 2 dhe 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar, dhe të nenit 15 të "Rregullores për Organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 25/3 prot., datë 802.2021, të drejtorive teknike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Furnizuesi i Tregut të Lirë" (FTL sh.a.), me shkresën nr. 320/1 prot., datë 4.2.2021, kërkoi nga ana e ERE-s shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi të "Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020, deri në fund të muajit prill 2021.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s, të sipërcituar, u vendos miratimi i "Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë, FTL sh.a.", hyrja në fuqi e së cilës u vendos pas botimit në Fletoren Zyrtare.

- Në shkresën e përcjellë nga FTL sh.a., me nr. 320/1 prot., datë 4.2.2021, shoqëria bën me dije se ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për realizimin e ndryshimit/zhvillimit në platformën IT *online* të blerjes së energjisë, me qëllim përdorimin e saj edhe për procedurat e shitjes. FTL sh.a. ndër të tjera në shkresë parashtron se është lidhur kontrata e shërbimit në datën 11 janar 2021, me subjektin fitues i cili do të bëjë ndërhyrjet në platformën IT *online*, si dhe në kontratë është përcaktuar se afati për implementimin e ndryshimeve/të zhvillimeve të platformës është 65 (gjashtëdhjetë e pesë) ditë nga data e lidhjes së kontratës.

- Nga analiza e afateve të raportuara nga vetë shoqëria FTL sh.a. në shkresën e sipërcituar, rezulton se hyrja në fuqi e "Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020, nuk mund të shtyhet deri në fund të muajit prill, siç shoqëria ka kërkuar, por deri më 31 mars 2021.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi të "Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020, deri më 31 mars 2021.

2. Për periudhën tranzitore, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, FTL sh.a., për qëllim të procedurës së shitjes së tepricave të energjisë elektrike, të përdorë "Rregullat e përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a.", të miratuar me vendimin nr. 5233/1, datë 12.6.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë FTL sh.a. dhe palët e interesit të përfshira në dhënien e opinioneve për draftin e "Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit", Shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 38, datë 11.2.2021

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN JANAR 2021

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 11.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 25/4 prot., datë 9.2.2021 nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit" për muajin janar 2021,

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.), me shkresën e saj nr. 1282 prot., datë 5.2.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin janar 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në kërkesën e FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit: bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, "Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021", është 0.75 lekë/kwh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, të Bordit të ERE, "Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes, sipas nivelit të tensionit për vitin 2021" është 1.5 lekë/kwh.

- Sasi e energjisë elektrike e prokuruar në treg të parregulluar dhe nga burimet e rinovueshme është 2000 mwh.

- Në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF-ja për muajin janar 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Janar 2021

	Janar 2021		Aplikimi FSHU sh.a.	Përllogaritjet e ERE
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	6.561	6.561
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.20	0.20
	Çmimi mesatar i blerjes ne periudhen relevante	Leke/kWh	6.76	6.76
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
	Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA	**Leke/kWh**	**10.80**	**10.80**

Për sa përcaktohet për çdo element të formulës përllogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionet e procedurës së blerjes së energjisë nga FTL sh.a., si dhe vlerësimeve të ERE-s sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin janar 2021, të jetë 10.80 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 10.80 lekësh/kwh, për muajin janar 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 39, datë 11.2.2021

MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 348, SERIA T16, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË "NORDIC INVEST GROUP" SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 121, DATË 21.7.2016

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 7, 8 dhe 9, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; pikës 5.1, germa "ç", të Kushteve të Licencës për Tregtimin e Energjisë Elektrike; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin,

funksionimin dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 11.2.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 25/1 prot., datë 5.2.2021, të përgatitur nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të kryetarit të ERE-s, mbi heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit,

konstatoi se:

- Shoqëria "Nordic Invest Group" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 348, seria T16, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 121, datë 21.7.2016, për një afat 5-vjeçar.

- Shoqërisë "Nordic Invest Group" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/16 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të kryetarit të ERE-s ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse, në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu, iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar me urdhrin sipërcituar.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "Nordic Invest Group" sh.p.k., nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 224, datë 15.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 348, seria T16, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Nordic Invest Group" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 121, datë 21.7.2016.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim me shkresën e ERE-s nr. 1172/16-1 prot., datë 23.12.2020, dhe i është bërë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë apo për të dhënë shpjegime, në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17, i këtij ligji.

- Në pikën 5.1, germa "ç", të Kushteve të Licencës së Tregtimit të Energjisë Elektrike parashikohet se ERE heq një licencë, kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.

- Në nenin 5, grema "ç", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet:

- ERE heq një licencë kur i licencuari:

ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit të energjisë elektrike ose nenin 14, të ligjit për gazin natyror.

- Në nenin 9, germa "c", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18. 4.2017, parashikohet se:

- Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat, sipas neneve 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë, për:

c) të hequr licencën, subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat "a", "b", "c", "ç" dhe/ose "d", të nenit 5, të kësaj rregulloreje, në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.

- Me heqjen e licencës nr. 348, seria T16, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 121, datë 21.07.2016, shoqëria "NORDIC INVEST GROUP" sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 348, seria T16, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Nordic Invest Group" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 121, datë 21.7.2016.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i punës të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "Nordic Invest Group" sh.p.k. dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 40, datë 11.2.2021

MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 405, SERIA P18K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË "MALSIA SOLAR 1" SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 105, DATË 30.4.2018

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 7, 8 dhe 9, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; të pikës 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 25/1 prot., datë 5.2.2021, të përgatitur nga grupi i punës, i ngritur me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të kryetarit të ERE-s, "Mbi heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit",

konstatoi se:

- Shoqëria "Malsia Solar 1" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 405, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 105, datë 30.4.2018, për një afat 25-vjeçar.

- Shoqërisë "Malsia Solar 1" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/13 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të kryetarit të ERE-s, ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse, në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu, iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar me urdhrin e sipërcituar.

- Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "Malsia Solar 1" sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkohet.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 227, datë 15.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 405, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Malsia Solar 1" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 105, datë 30.4.2018.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim me shkresën e ERE-s, nr. 1172/13-1 prot., datë 23.12.2020, dhe i është bërë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë apo për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në

fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, parashikohet se ERE heq një licencë, kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17, i këtij ligji.

- Në pikën 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës" së prodhimit të energjisë elektrike, parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit të vendosura nga ERE.

- Në nenin 5, germa "ç", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet:

- ERE heq një licencë, kur i licencuari:

ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit për energjinë elektrike ose nenin 14, të ligjit për gazin natyror.

- Në nenin 9, germa "c", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

- Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat, sipas neneve 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë, për:

c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat "a", "b", "c", "ç" dhe/ose "d", të nenit 5, të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.

- Me heqjen e licencës nr. 405, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 105, datë 30.4.2018, shoqëria "Malsia Solar 1" sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 405, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Malsia Solar 1" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 105, datë 30.4.2018.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i punës të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "Malsia Solar 1" sh.p.k. dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 41, datë 11.2.2021

MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 406, SERIA P18K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "MALSIA SOLAR 2" SHPK ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 106, DATË 30.4.2018

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 7, 8 dhe 9, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; të pikës 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 25/1 prot., datë 5.2.2021, të përgatitur nga Grupi i Punës i ngritur me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të Kryetarit të ERE-s, "Mbi heqjen e

licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit",

konstatoi se:

- Shoqëria "Malsia Solar 2" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 406, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 30.4.2018, për një afat 25-vjeçar.

- Shoqërisë "Malsia Solar 2" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/14 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të Kryetarit të ERE-s, ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu, iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar me urdhrin sipërcituar.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "Malsia Solar 2" sh.p.k., nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 228, datë 15.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 406, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Malsia Solar 2" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 30.4.2018.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim me shkresën e ERE-s nr. 1172/14-1 prot., datë 23.12.2020 dhe i është bërë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë apo për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17, i këtij ligji.

- Në pikën 6.1, germa "ç", të kushteve të licencës së prodhimit të energjisë elektrike parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.

- Në nenin 5, germa "ç", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet:

"ERE heq një licencë kur i licencuari:

ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit "Për energjinë elektrike" ose nenin 14, të ligjit "Për gazin natyror".".

- Në nenin 9, germa "c", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

"Me marrjen e informacionit të detajuar, me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:

c) të hequr licencën, subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat; "a", "b", "c", "ç" dhe / ose "d", të nenit 5, të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.".

- Me heqjen e licencës nr. 406, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 30.4.2018, shoqëria "Malsia Solar 2" sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 406, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Malsia Solar 2" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 30.4.2018.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i Punës të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "Malsia Solar 2" sh.p.k. dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 42, datë 11.2.2021

MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 407, SERIA P18K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "MALSIA SOLAR 3" SHPK ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 107, DATË 30.4.2018

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 7, 8 dhe 9, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të pikës 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.2.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 25/1 prot., datë 5.2.2021, të përgatitur nga Grupi i Punës, i ngritur me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të Kryetarit të ERE-s, mbi heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit,

konstatoi se:

- Shoqëria "Malsia Solar 3" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 407, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 107, datë 30.4.2018, për një afat 25-vjeçar.

- Shoqërisë "Malsia Solar 3" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/15 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të Kryetarit të ERE-s, ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu, iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar me urdhrin sipërcituar.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "Malsia Solar 3" sh.p.k., nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 229, datë 15.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 407, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Malsia Solar 3" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 107, datë 30.4.2018.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim me shkresën e ERE-s nr. 1172/15-1 prot., datë 23.12.2020 dhe i është bërë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë apo për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Në pikën 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës së prodhimit të energjisë elektrike"

parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.

- Në nenin 5, germa "ç", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet:

"ERE heq një licencë kur i licencuari:

ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit të energjisë elektrike ose nenin 14, të ligjit për gazin natyror.".

- Në nenin 9, germa "c", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

" Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat, sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:

c) të hequr licencën, subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat: "a", "b", "c", "ç" dhe/ose "d", të nenit 5, të kësaj rregulloreje, në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.

- Me heqjen e licencës nr. 407, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 107, datë 30.4.2018, shoqëria "Malsia Solar 3" sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 407, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Malsia Solar 3" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 107, datë 30.4.2018.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i Punës të njoftojë të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "Malsia Solar 3" sh.p.k. dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 43, datë 11.2.2021

MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 398, SERIA T18, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "WIND POWER ALBANIA" SHPK ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 58, DATË 12.3.2018

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e eenergjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 7, 8 dhe 9, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 58, datë 18.4.2017; të pikës 5.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.2.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 25/1 prot., datë 5.2.2021, të përgatitur nga Grupi i Punës, i ngritur me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të Kryetarit të ERE-s, mbi heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit,

konstatoi se:

- Shoqëria "Wind Power Albania" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 398, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 12.3.2016, për një afat 5-vjeçar.

- Shoqërisë "Wind Power Albania" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/17 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe

reduktimit të gjobave", me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të Kryetarit të ERE-s, ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu, iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin sipërcituar.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezulton se subjekti "Wind Power Albania" sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 231, datë 15.12.2020, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 398, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Wind Power Albania" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 12.3.2018.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim me shkresën e ERE-s nr. 1172/17-1 prot., datë 23.12.2020 dhe i është bërë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar, rezulton se subjekti nuk ka marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë apo të ketë dhënë shpjegime në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës, për marrjen e masës administrative, për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17, i këtij ligji.

- Në pikën 5.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike" parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.

- Në nenin 5, germa "ç", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

"ERE heq një licencë kur i licencuari:

ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit të energjisë elektrike ose nenin 14 të ligjit për gazin natyror.".

- Në nenin 9, germa "c", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

"Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:

c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat: "a", "b", "c", "ç" dhe/ose "d", të nenit 5, të kësaj rregulloreje, në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.".

- Me heqjen e licencës nr. 398, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 12.3.2018, shoqëria "Wind Power Albania" sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 398, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Wind Power Albania" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 12.3.2018.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i Punës të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "Wind Power Albania" sh.p.k. dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 44, datë 11.2.2021

MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 413, SERIA F18, PËR VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "WIND POWER ALBANIA" SHPK ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 126, DATË 4.6.2018

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 7, 8 dhe 9, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 58, datë 18.4.2017; të pikës 6.2, të "Kushteve të licencës për furnizimin e energjisë elektrike"; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 11.2.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 25/1 prot., datë 5.2.2021, të përgatitur nga Grupi i Punës i ngritur me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020 të Kryetarit të ERE-s, mbi heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit,

konstatoi se:

- Shoqëria "Wind Power Albania" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 413, seria F18, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 4.6.2018, për një afat 5-vjeçar.

- Shoqërisë "Wind Power Albania" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/17 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të Kryetarit të ERE-s, ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu, iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin sipërcituar.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "Wind Power Albania" sh.p.k., nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 232, datë 15.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 413, seria F18, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Wind Power Albania" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 4.6.2018.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim me shkresën e ERE-s nr. 1172/17-1 prot., datë 23.12.2020 dhe i është bërë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë apo për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Në pikën 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës së prodhimit të energjisë elektrike" parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.

- Në nenin 5, germa "ç", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

"ERE heq një licencë kur i licencuari:

ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet në nenin 1,7 të ligjit të energjisë elektrike ose nenin 14, të ligjit për gazin natyror.".

- Në nenin 9, germa "c", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të

miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

"Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:

c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat: "a", "b", "c", "ç" dhe/ose "d", të nenit 5, të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.".

- Me heqjen e licencës nr. 413, seria F18, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 4.6.2018, shoqëria "Wind Power Albania" sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 413, seria F18, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Wind Power Albania" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 4.6.2018.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i Punës të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "Wind Power Albania" sh.p.k. dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 45, datë 11.2.2021

MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 359, SERIA T17, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË "ENPI" SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 36, DATË 6.3.2017

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 7, 8 dhe 9, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të pikës 5.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.2.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 25/1 prot., datë 5.2.2021, të përgatitur nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të kryetarit të ERE-s, mbi heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit,

konstatoi se:

- Shoqëria "ENPI" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 359, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 36, datë 6.3.2017, për një afat 5-vjeçar.

- Shoqërisë "ENPI" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/20 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të kryetarit të ERE-s ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse, në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu, iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e sipërcituar.

- Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "ENPI" sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkohet.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 233, datë 15.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 359, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "ENPI" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 36, datë 6.3.2017.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim me shkresën e ERE-s nr. 1172/20-2 prot., datë 23.12.2020, dhe i është bërë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë apo për të dhënë shpjegime, në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, parashikohet se ERE heq një licencë, kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17, i këtij ligji.

- Në pikën 5.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike" parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit të vendosura nga ERE.

- Në nenin 5, germa "ç", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

ERE heq një licencë kur i licencuari:

ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit të energjisë elektrike ose nenin 14, të ligjit për gazin natyror.

- Në nenin 9, germa "c", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat, sipas neneve 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:

c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat "a", "b", "c", "ç" dhe/ose "d", të nenit 5, të kësaj rregulloreje, në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje.

- Me heqjen e licencës nr. 359, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 36, datë 6.3.2017, shoqëria "ENPI" sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 359, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "ENPI" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 36, datë 6.3.2017.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i punës të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "ENPI" sh.p.k. dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 46, datë 11.2.2021

MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 384, SERIA T17, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "ENERGY TO ENERGY" SHPK ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 144, DATË 6.9.2017

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 7, 8 dhe 9, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; të pikës 5.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 25/1 prot., datë 5.2.2021, të përgatitur nga Grupi i Punës i ngritur me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të Kryetarit të ERE-s, mbi heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit,

konstatoi se:

- Shoqëria "Energy to Energy" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 384, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.9.2017, për një afat 5-vjeçar.

- Shoqërisë "Energy to Energy" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/12 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të Kryetarit të ERE-s, ka filluar procedurat hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu, iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar me urdhrin sipërcituar.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "Energy to Energy" sh.p.k., nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 234, datë 15.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 384, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Energy to Energy" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.9.2017.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim me shkresën e ERE-s nr. 1172/12-1 prot., datë 23.12.2020 dhe i është bërë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë apo për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17, i këtij ligji.

- Në pikën 5.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike" parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.

- Në nenin 5, germa "ç", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

"ERE heq një licencë kur i licencuari:

ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit për energjisë elektrike ose nenin 14, të ligjit për gazin natyror.".

- Në nenin 9, germa "c", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të

miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

"Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:

c) të hequr licencën, subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat: "a", "b", "c", "ç" dhe/ose "d", të nenit 5, të kësaj rregulloreje, në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje.".

- Me heqjen e licencës nr. 384, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 9.3.2017, shoqëria "Energy to Energy" sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 384, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Energy to Energy" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.9.2017.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i Punës të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "Energy to Energy" sh.p.k. dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 47, datë 11.2.2021

MBI PLOTËSIMIN E KUSHTIT TË VENDIMIT NR. 114, DATË 22.7.2019, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'SPE GJADËR' SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC 'GJADËR NR. 1/1' ME KAPACITET TË INSTALUAR 2134 kw, HEC 'GJADËR NR. 1/2' ME KAPACITET TË INSTALUAR 4406 kw, HEC 'GJADËR NR. 2' ME KAPACITET TË INSTALUAR 2983 kw, HEC 'GJADËR NR. 3' ME KAPACITET TË INSTALUAR 3874 kw, HEC 'GJADËR NR. 4' ME KAPACITET TË INSTALUAR 5922 kw, HEC 'GJADËR NR. 5' ME KAPACITET TË INSTALUAR 5619 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 24938 kw", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a", dhe nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 20/1-1 prot., datë 8.2.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me plotësimin e kushtit të vendimit nr. 114, datë 22.7.2019, mbi licencimin e shoqërisë "SPE Gjadër" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 114, datë 22.7.2019, vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë "SPE Gjadër" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga: "HEC Gjadër nr. 1/1" me kapacitet të instaluar 2134 kV, "HEC Gjadër nr. 1/2" me kapacitet të instaluar 4406 kw, "HEC Gjadër nr. 2" me kapacitet të instaluar 2983 kw, "Hec Gjadër nr. 3" me kapacitet të instaluar 3874 kw, "HEC Gjadër nr. 4" me kapacitet të instaluar 5922 kw, "HEC Gjadër nr. 5" me kapacitet të instaluar 5619 kw; me kapacitet të instaluar total 24938 kw, për një afat 29 vjet e 2 muaj, të ndryshuar me vendimin nr. 239, datë 23.12.2019.

- Kushtet e vendimeve të sipërcituara qëndronin në ndërtimin e veprës, vënien e saj në punë dhe lidheshin gjithashtu me pretendimin e shoqërisë se për vitet e humbura të koncesionit do t'i kërkonte në vijim Autoritetit Kontraktor një kontratë shtesë e cila do të mundësonte zgjatjen e periudhës së koncesionit, periudhë kjo e humbur për shkak të aplikimeve në AZHT dhe problematikave të hasura, për të cilat shoqëria ka bërë me dije edhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

- Sa konstatuar, pavarësisht gjithë përpjekjeve që shoqëria kishte bërë për të plotësuar këtë kusht, pra aplikimin për lejen e ndërtimit, që nga fillimet e aplikimit për licencë në ERE, rezultoi se plotësimi i kushteve të vendimeve të ERE-s nuk varej nga vullneti i shoqërisë së licencuar, por nga ai i institucioneve shtetërore.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 71/1 prot., datë 18.1.2021, mbërriti për dijeni komunikimi i Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL sh.a.) drejtuar shoqërisë "SPE Gjadër" sh.p.k., me anë të së cilës kjo e fundit i kthen përgjigje kërkesës së shoqërisë për lidhjen e kontratës së shitjes së energjisë elektrike për HEC në lumin Gjadër, duke i thënë se më parë duhet të plotësojë kushtet e vendimit të licencimit nr. 114, datë 22.7.2019, të ndryshuar.

- Nisur nga sa më sipër, ERE, me shkresën nr. 71/2 prot., datë 1.2.2021, iu drejtua shoqërisë "SPE Gjadër" sh.p.k., duke i kërkuar informacion në lidhje me kërkesën drejtuar FTL sh.a., për lidhjen me rrjetin e shpërndarjes, në lidhje me ndërtimin e veprës dhe kohën e parashikuar për vënien në punë të HEC-eve Gjadër, duke qenë me herët në dije në lidhje me problematikën e lejes së ndërtimit referuar të cilës janë orientuar edhe kushtet e vendimeve respektive.

- Në përgjigje të sa me sipër, shoqëria "SPE Gjadër" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 71/3 prot., datë 4.2.2021, ka përcjellë në ERE informacion lidhur me sa kërkuar duke bërë me dije se aktualisht ndodhet në fund të testimit të veprës dhe në vënien në operim të saj, fakt i cili i është bërë me dije dhe vetë MIE-s, si dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore me shkresën nr. 338, datë 1.2.2021. Këtë shkresë shoqëria e ka depozituar edhe në ERE.

- Shoqëria vijon duke argumentuar se vonesa në lidhjen e kontratës me FTL sh.a. e vë në vështirësi të mëdha financiare pas përfundimit të një vepre për të cilin është kryer një investim shumë i madh.

- Nisur nga sa më sipër, duke qenë se kushti i vendosur në vendimin nr. 239, datë 23.12.2019, "Për ndryshimin e vendimit nr. 114, datë 22.7.2019, për licencimin e shoqërisë 'SPE Gjadër'", lidhej pikërisht me shtyrjen e afatit të punimeve të veprës me një kontratë shtesë koncesioni dhe aktualisht jemi përpara faktit të dokumentuar nga shoqëria për përfundimin e ndërtimit të saj, dhe mbetjen e njëjtë të afateve të mbetura të koncesionit, pra 29 vjet e 2 muaj, siç është llogaritur në momentin e licencimit të shoqërisë me vendimin nr. 114, datë 22.7.2019, kushti i vendosur në këtë vendim është plotësuar nga ana e shoqërisë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 1, të vendimit të ERE-s nr. 114, datë 22.7.2019, të ndryshuar, si vijon:

a) Të licencojë shoqërinë "SPE Gjadër" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga: "HEC Gjadër nr. 1/1" me kapacitet të instaluar 2134 kV, "HEC Gjadër nr. 1/2" me kapacitet të instaluar 4406 kw, "HEC Gjadër nr. 2" me kapacitet të instaluar 2983 kw, "Hec Gjadër nr. 3" me kapacitet të instaluar 3874 kw, "HEC Gjadër nr. 4" me kapacitet të instaluar 5922 kw, "HEC Gjadër nr. 5" me kapacitet të instaluar 5619 kw; me kapacitet të instaluar total 24938 kw, për një afat 29 vjet e 2 muaj.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 6/18, datë 1.3.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Spitalit Rajonal Fier".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" dhe në VKM nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 20,892,266 (njëzetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

KRYETAR
I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË
SHPRONËSIMIT
Erlis Hereni

LISTA PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I SPITALIT RAJONAL FIER"

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m^2)	Shpronësim tokë "arë"			Drufrutorë/kultura bujqësore	VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME
								Sip. (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera lekë			
1	Myzafer	Qazim	Ferko	3980	15/5	arë	7700	5,189	269	1,395,841.00	0	1,395,841.00	KONFIRMUAR ASHK
2	Ramazan	Qazim	Ferko	3980	15/6	arë	6,343	4,151	269	1,116,619.00	482,010	1,598,629.00	KONFIRMUAR ASHK
3	Vjollca, Kujtim	Sotir, Sotir	Hodaj, Cuko	3980	15/13	arë	3,000	2,122	269	570,818.00	0	570,818.00	KONFIRMUAR ASHK
4	Nasi	Sotir	Cuko	3980	15/14	arë	4,519	3,215	269	864,835.00	69,800.00	934,635.00	KONFIRMUAR ASHK
5	Sadush, Vezire, Iljaz, Adem, Engjellueshe, Rasim	Haxhi, Sadush, Sadush, Sadush, Sadush, Sadush,	Ferko, Xhelaj, Ferko, Ferko, Ferko Ferko	3980	15/19	arë	5,400	3,808	269	1,024,352.00	2,216,480.00	3,240,832.00	KONFIRMUAR ASHK
6	Shtet			3980	15/20	arë	1,112	766	-	-	0	-	KONFIRMUAR ASHK
7	Nasi	Sotir	Cuko	3980	15/21	arë	3,201	2,219	269	596,911.00	0	596,911.00	KONFIRMUAR ASHK
8	Lulzim, Seada	Pelivan, Bajram	Troka, Troka	3980	15/23	arë	7,710	5,432	269	1,461,208.00	248,070.00	1,709,278.00	KONFIRMUAR ASHK
9	Trifon	Sotir	Cuko	3980	15/25	arë	7,720	5,374	269	1,445,606.00	242,580.00	1,688,186.00	KONFIRMUAR ASHK
10	Iliaz	Sadush	Ferko	3980	15/26	arë	6,180	4,210	269	1,132,490.00	2,185,900.00	3,318,390.00	KONFIRMUAR ASHK
11	Fatmir	Sadush	Ferko	3980	15/30	arë	6,950	4,787	269	1,287,703.00	762,080.00	2,049,783.00	KONFIRMUAR ASHK
12	Nexhmije, Teuta, Amarildo, Paola	Liko, Piro , Piro, Piro	çuko, çuko, çuko, Kaleci	3980	15/31	arë	6,847	4,675	269	1,257,575.00	182,640.00	1,440,215.00	KONFIRMUAR ASHK
13	Adem	Sadush	Ferko	3980	15/32	arë	6,000	4,052	269	1,089,988.00	1,258,760.00	2,348,748.00	KONFIRMUAR ASHK
VLERA TOTALE PARAPRAKE												**20,892,266.00**	

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 32
Datë: 2021/03/02 14:39:44
770ebdb4-9787-44e8-a61c-70e4229ec67f

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 208 lekë